



Indeksi i integritetit të zgjedhjeve

Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë
25 prill 2021

Tiranë, Qershor, 2021



Indeksi i integritetit të zgjedhjeve
Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë
25 prill 2021

Hartoi

Prof Asoc. Dr. Andon Kume
Dr. Linert Lirëza

Drejtues metodik
Prof.Dr. Kristaq Kume

© **INSIZ/AIESD**

Mbështetur nga:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e INSIZ/AIESD dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pozicionin zyrtar të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



PAQYRË E LËNDËS

Përmbledhje	1
I. Hyrje.....	5
II. Indeksi i integritetit te zgjedhjeve	7
III. Metodologjia	9
IV. Vlerësim i indikatorëve	
1. Kuadri ligjor	11
2. Zbatimi i procedurave elektorale	13
3. Ndarja e zonave zgjedhore	16
4. Lista e zgjedhësve	17
5. Rregjistrimi i subjekteve zgjedhore	19
6. Media dhe fushata zgjedhore	21
7. Financimi dhe fushata zgjedhore	23
8. Dita e votimit	26
9. Vlerësimi, numerimi i votave dhe tabelimi i rezultateve	28
10. Ankime për rezultatin	29
11. Autoritete zgjedhore	31
V. Indeksi i integritetit të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë	
25 prill 2021	32
VI. Vështrim krahasues-Indeksi i integritetit të zgjedhjeve	
PEI ₂₀₁₇ vs PEI ₂₀₂₁	34



INSTITUTI SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E SISTEMIT TË ZGJEDHJEVE
ALBANIAN INSTITUTE FOR ELECTION SYSTEM DEVELOPMENT

Rr. "Abdyl Frashëri" Pall.3/3, shk.5 Tirana, Albania Tel/Fax ++355 42 22414 03

www.insiz.org

Përmbledhje

Zhvillim i zgjedhjeve në përputhje me standardet për zgjedhje të lira e demokratike dhe në zbatim të parimeve të trashëgimisë zgjedhore europiane dhe angazhimeve të OSBE-se- është kusht themelor për zhvillimin e demokracisë. Kudo por, në veçanti në vendet që janë në proceset e formimit të kulturës dhe të sjelljeve si shoqëri demokratike, realizimi i zgjedhjeve të tilla është një ndër sfidat më komplekse dhe ndër më të vështirat për t'u përballuar me sukses.

Zgjedhjet bëjnë pjesë ndër proceset e pakta politike e sociale që zhvillohen në shoqëritë demokratike, në të cilët marrin pjesë dhe kanë përgjegjësi dhe detyrime pothuajse të gjithë, qytetarët si zgjedhës, organizatat e shoqërisë civile, institucionet e ndryshme që i përkasin pushtetit legjislativ qëndror e lokal, pushtetit ekzekutiv e gjyqësor.

Rregullat dhe parimet drejtuese të demokracisë kërkojnë që shoqëria civile të angazhohen në proceset zgjedhore, në të gjithë komponentet dhe fazat e zhvillimit të tyre. Pjesëmarrja e saj në përgatitjen e kuadrit ligjor për zgjedhjet dhe angazhimi për monitorimin dhe vëzhgimin e procesit zgjedhor, që nga dita e dekretimit të datës së zgjedhjeve dhe deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar, është detyrim që duhet të plotësohen nga çdo shoqëri që është e deklaruar se zhvillohet në bazë të parimeve të një shoqërie demokratike.

Në Shqipëri, shoqëria civile është angazhuar në monitorimin dhe vëzhgimin e zgjedhjeve menjëherë pas ndryshimeve që ndodhën në sistemin qeverisës dhe me institucionalizimin e pluralizmit politik, në fillim të viteve '90. Ndër vite ky angazhim ka patur si pjesë të pandarë të tij përpjekjet për aftësimin profesional dhe zhvillimin organizativ të vëzhguesve vendor. Rezultatet e këtyre përpjekjeve janë finalizuar me gjykimet dhe vlerësimet e dhëna në raportet përfundimtare për zgjedhjet e vëzhguara.

Vlerësimi i Indeksit të Integritetit të zgjedhjeve (IIZ), për herë të parë në Shqipëri është realizuar nga IDM, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, 2015. Ai shënoi edhe fillimin e procesit të ndryshimeve cilësore në kontributin e shoqërisë civile për gjykimin dhe vlerësimin e proceseve zgjedhore në Shqipëri.

Indeksi i Integritetit të zgjedhjeve është një tregues sasior që shërben për të gjykuar për nivelin e plotësimit të standardeve të gjithëpranuara demokratike në një proces zgjedhor. Për vlerësimin e këtij indeksi merren parasysh dhe përdoren vlerësimet për perceptimet për masën e plotësimit të këtyre standardeve në faza dhe për procedura të ndryshme të procesit zgjedhor. Indeksi është një shumim mesatar i vlerave të këtyre perceptimeve për cilësinë e procesit legjislativ dhe produktit të tij dhe për zbatimin e legjislacionit zgjedhor nga të gjithë pjesëmarrësit në zgjedhje, duke filluar nga qytetarët, administrata zgjedhore, institucionet e pushtetit qëndror e lokal dhe gjithë institucionet e tjera ligjzbatuese që kanë detyra në një proces zgjedhor.

Për vlerësimin e Indeksit të Integritetit të zgjedhjeve (PEI) për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, 26 prill 2021, u përdor Metodologjia e hartuar nga Pippa, N. et at... (2019). Për këtë qëllim, INSIZ angazhoi një ekip prej 10 specialistësh me formim në shkencat juridike e politike, të cilët grumbulluan

të dhënat që pasqyrojnë, në mënyrë sasore, perceptimet për çështje dhe për zhvillimin e fazave të ndryshme të procesit zgjedhor. Krahas këtyre të dhënave, për vlerësimin e Indeksit të Integritetit të zgjedhjeve për zgjedhjet parlamentare, 25 prill 2021, u përdor edhe informacioni i komunikuar nga vëzhgues dhe organizata të tjera që i vëzhguan këto zgjedhje.

Indeksi i Integritetit të Zgjedhjeve u vlerësuar duke përdorur vlerat mesatare të perceptimeve për 11 indikatorë. Këto vlera mesatare u llogariten duke përdorur vlerësimet për 147 treguesit, çdo njëri prej të cilëve, në bazë të perceptimit korespondues, mund të jepej vlera nga 1 (aspak dakort) deri në 5 (shumë dakort). Vlera mesatare e llogaritur për secilin indikator u standartizua, duke u konvertuar në vlerë në intervalin 0-100 pikë. Mbështetur në vlerën mesatare të standartizuar, integriteti i zgjedhjeve vlerësohet: shumë i ulët (≤ 40 pikë), i ulët ($40^+ - 50$ pikë), i moderuar ($45^+ - 60$ pikë), i lartë ($60^+ - 70$ pikë) dhe shumë i lartë ($\geq 70^+$ pikë).

Për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, 25 prill 2021, vlerësimi për Integritetin e Zgjedhjeve (PEI) dhe për secilin prej indikatorëve të marr në konsideratë, jepet në Fig. no. 1




Fig. Nr. 1 Indeksi i Integritetit të Zgjedhjeve - Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, 25 Prill 2021

Mbështetur në rezultatet e paraqitura në Fig. no. 1, mund të pohohet se:

Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, 25 prill 2021, ishin një proces, që në tërësinë e tij vlerësohet në nivelin "I moderuar". Në krahasim me zgjedhjet parlamentare të zhvilluara në vitin 2017, për të cilat Pippa, N. *et al.* kanë vlerësuar $PEI_{2017} = 53.2$ pikë, Indeksi është përmirësuar me rreth 8.3 pikë përqindje. Megjithë këtë, zgjedhjet në Shqipëri vazhdojnë të vlerësohen si procese që nuk arrijnë të kapërcejnë nivelin e zgjedhjeve të moderuara.

Duke ju referuar Pippa, N. et al (2014), një fakt i tillë tregon se:

Shqipëria vazhdon të jetë vend i cili ballafaqohet me sfida dhe probleme akoma të pazgjidhura në procesin e zhvillimit si një shoqëri demokratike, proces në të cilin zgjedhjet janë një ndër komponentet e rëndësishme të tij.

Në rritjen e vlerësuar (8.3 pikë përqindje) për Indeks të integritetit të zgjedhjeve, 25 prill 2021, si shihet kontribut të ndjeshëm kanë indikatorët që pasqyrojnë procesin e votimit ditën e zgjedhjeve dhe procesin e numërimit të votave. Të dy këto faza të procesit zgjedhor perceptohen se janë zhvilluar në përputhje me kërkesat e ligjit dhe, në përgjithësi ato i kanë plotësuar edhe kërkesat që rrjedhin nga standardet që duhet të plotësojnë zgjedhjet demokratike për procesin e votimit dhe numërimit të votave.

Ndër indikatorët me efekt negativ më të madh në integritetin e zgjedhjeve vlerësohen “Ndarja e zonave zgjedhore”, “Financimi i fushatës zgjedhore” dhe “Ankimimet”.

Perceptimet për efektin negativ që gjeneroi në integritetin e zgjedhjeve ndarja në zona zgjedhore e vendit, është pasojë e faktit se kjo ndarje i diskriminoi partitë e vogla dhe partitë e reja politike. Kjo ndarje perceptohet si faktor me efekt negativ në fuqinë e votës. Së bashku me pragun kombëtar ato perceptohen si kushtëzime ligjore që, në mënyrë të veçantë i vendosën në pozita të pabarabarta gare, partitë e vogla dhe kandidatët e pavarur, në krahasim me partitë e mëdha, PS e PD.

Vlera mesatare e treguesve përbërës të financimit të fushatës zgjedhore rezultoi 2.49 (37.25 pikë), duke e klasifikuar atë në nivelin “shumë i ulët”. Ndërkohë, vlera mesatare e treguesve që pasqyrojnë fushatën zgjedhore rezultoi 2.88 (47.00 pikë) duke e klasifikuar fushatën zgjedhore në nivelin “i ulët”. Ndër treguesit me efekte më të forta negative, që perceptohen se kanë ndikuar në vlerat e ulta të këtij indikator, renditen:

- Vullneti i munguar i partive politike për të zbatuar kërkesat e Kodit zgjedhor në lidhje me financimin e fushatës.
- Shpeshësia e fenomenit të shitblerjes së votës.
- Përdorimi i të dhënave personale për qëllime të garës zgjedhore.
- Përdorimi për qëllime të fushatës zgjedhore të aseteve publike, fondeve financiare publike dhe aktiviteteve publike. Në veçanti përdorimi nga PS, në kundërshtim me kërkesat e ligjit, gjermën ose frymën e tyre, të të gjitha mundësive që i jepte të qenit parti qeverisëse, në nivel Qëndror dhe lokal.
- Niveli i pamjaftueshëm i realizimit të pritshmërive nga monitorimin, në kohë reale, i shpenzimeve të partive politike gjatë dhe për fushatën zgjedhore.
- Reagimi i institucionet ligjzbatuese, policisë së shtetit, prokurorisë dhe SPAK në parandalimin dhe dënimin e shkeljeve të ligjit zgjedhor.

Administrimi i ankimeve nga KAS dhe gjykimi i padive, perceptohet si tregues me efekt negativ në integritetin e zgjedhjeve. Ankimuesit e vlerësuan, në të gjithë rastet, vendmimirin e KAS të ndikuar nga interesi politik i partisë socialiste. Sipas tyre edhe gjykimi prej Kolegjit zgjedhor i padive të tyre për vendimet e KAS, u bë nën presionin politik.

Për vlerësimin e indikatorit “Ankime” merret në konsideratë, si tregues i rëndësishëm edhe qëndrimi i subjekteve zgjedhore ndaj rezultatit të zgjedhjeve. Partitë politike humbëse, PD e LSI, u deklaruan kundër rezultatit, duke e argumentuar qëndrimin e tyre me nivelin e lartë të përdorimit prej PS, të aseteve publike dhe mundësive që i jepte qenia si parti qeverisëse, shitblerjen e votës dhe intimidimin e madh të zgjedhësve. Për pasojë edhe kontributi i këtij treguesi në vlerën e indikatorit “Ankime”, si përbërës i Indeksit të integritetit të zgjedhjeve është negativ.

Legjislacioni zgjedhor vlerësohet si një indikator që, në krahasim me zgjedhjet e viti 2013 dhe 2017, nuk ka bërë progres. Ai vazhdon të klasifikohet në nivelin “I moderuar”. Megjithëse në Kodin zgjedhor, të miratuar në bazë të Marrveshjes së 5 qershorit u bënë ndryshime dhe përmirësime të rëndësishme, ky indikator vlerësohet në këtë nivel të ulët, si pasojë e faktit se, ndryshimet në Kushtetutë dhe ndryshimet që pasuan në Kodin zgjedhor, u bënë pa konsensusin e palëve.

Administrata zgjedhore vlerësohet si një indikator me efekt pozitiv në Integritetin e zgjedhjeve. Ky indikator klasifikohen në nivelin “I lartë”. Efekti kryesor për këtë perceptim është i lidhur me perceptimin pozitiv të punës së Komisionerit shtetor dhe me nivelin e lartë të transparencës në punën e KQZ-se.

Lista e zgjedhësve dhe regjistrimi i subjekteve zgjedhor janë dy indikator për të cilët vlerat mesatare të perceptimeve i klasifikojnë në nivelin “I lartë”.

Perceptimi për rolin e medias dhe për nivelin e zbatimit prej saj të kërkesave të Kodit zgjedhor, e klasifikoi këtë indikator në nivelin “I moderuar”. Krahasuar me zgjedhjet e mëparshme parlamentare, për këtë indikator është perceptuar një rritje me rreth 16.9 pikë përqindje, duke e pozicionuar atë nga niveli “I ulët” në nivelin “I moderuar”.

I. Hyrje

Zgjedhjet janë një prej momenteve më të rëndësishme të ushtrimit të drejtave themelore të njeriut, të drejtat civile dhe politike. Për pasojë, monitorimi dhe vëzhgimi i tyre është e nevojshme të organizohet dhe realizohet, duke e konsideruar atë si një e drejte, detyrë dhe si realizim i përgjegjësive të shoqërisë civile, në mbështetje dhe mbrojtje të këtyre të drejtave.

Një proces zgjedhor është demokratik vetëm në se:

- realizohet si një konkurrencë e ndershme;
- zhvillohet në një mjedis të karakterizuar nga besueshmëria, transparencja dhe llogaridhënia;
- arrin t`ju sigurojë kushte të barabarta gare të gjithë subjekteve që përfshihen në të;
- qytetarët informohen, pa dallim, për të drejtat dhe detyrat e tyre si zgjedhës, për rregullat që duhet të respektojnë në procesin e votimit dhe për alternativat, programet dhe kandidatët që garojnë;
- kuadri ligjor dhe zbatimi i tij mundësojnë respektimin dhe plotësimin e të drejtës për shprehjen e lirë, median e lirë, lirinë e bashkimit, lirinë për krijimin e partive politike, bashkëpunimin politik, lëvizjen e lirë, respektimin e parimeve të shtetit të të drejtës, të drejtën e barabartë për të konkuruar për poste publike, mosdiskriminimin dhe të drejta të barabarta për të gjithë qytetarët.

Vëzhgimi i zgjedhjeve prej grupeve qytetare, si vëzhgues të pavarur politik, është një proces i rëndësishëm me efekte domethese në procesin zgjedhor. Nëpërmjet tij qytetarët arrijnë të gjykojnë, vetë dhe të pandikuar, për ecurinë e të gjithë procesit zgjedhor, për nivelin e respektimit të ligjit prej administratës zgjedhore, prej garuesve, partive politike dhe institucioneve të tjera që ligji i ngarkon me detyra në kuadër të zgjedhjeve. Qytetari vëzhgues është një faktor presioni pozitiv për zbatimin e ligjit dhe respektimin e procedurave prej administratës zgjedhore dhe prej vetë qytetarëve në procesin e votimit.

Pjesëmarrja e qytetarëve në procesin e vëzhgimit të zgjedhjeve, si vëzhgues të pavarur, i shërben rritjes së përgjegjësisë dhe transparencës në procesin zgjedhor, rritjes së kredibilitetit të këtij procesi. Kjo pjesëmarrje është konkretizim i rëndësishëm i zbatimit të parimeve universale për zgjedhje demokratike, të parashikuara nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Neni 21, sipas të cileve:

- Gjithkush ka të drejtë të marrë pjesë në qeverisjen e vendit të vet, drejtpërdrejt ose me anë të përfaqësuesve të zgjedhur lirisht.
- Gjithkush ka njëllojë të drejtë të hyjë në shërbimet publike në vendin e vet.
- Vullneti i popullit është baza e pushtetit shtetëror; ky vullnet duhet të shprehet në zgjedhje periodike dhe të lira, të cilat duhet të jenë të përgjithshme, votimi i barabartë dhe i fshehtë.

Çdo proces zgjedhor fillon me dekretimin e datës së zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës dhe përfundon me shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve prej Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve. Si rregull, procesi zgjedhor paraprihet nga një proces legjislativ i cili realizon ndryshimet e nevojshme në Kodin zgjedhor, me synim që kuadri ligjor zgjedhor të krijojë kushte sa më të mira për zhvillimin e zgjedhjeve në përputhje me standardet demokratike, të gjithëpranuara.

Proçesi zgjedhor zhvillohet në tre faza kryesore: para ditës së zgjedhjeve, dita e votimit dhe pas ditës së votimit: nxjerrja e rezultatit, shqyrtimi i ankimeve dhe deklarimi i rezultatit përfundimtar. Në çdo njëren prej këtyre tre fazave, proçesi duhet të zhvillohet në përputhje dhe zbatim të procedurave të parashikuara në ligjin zgjedhor dhe udhëzimet e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve. Në mënyrë të përmblendhur këto procedura mund të renditen si më poshtë:

Para ditës së zgjedhjeve

- Përgatitet dhe miratohet kuadri nënligjor (udhëzimet e KQZ) në zbatim të të cilit duhet të zhvillohet i gjithë proçesi zgjedhor, në të gjithë fazat e ndryshme të tij
- Institucionalizohen KZAZ
- Regjistrohen subjektet zgjedhore dhe kandidatët
- Përgatitet lista e zgjedhësve
- Zhvillohet fusha zgjedhore
- Shpërndahen materialet zgjedhore deri në KQV

Gjatë ditës së zgjedhjeve

- Hapen qendrat e votimit përpara ores 7.00
- Kryhet votimi deri në oren e parashikuar në Kodin Zgjedhor
- Mbyllet votimi, administrohen materialet zgjedhore dhe kutite e votimit dhe dergohen në vendet e numërimit

Pas ditës së votimit

- Vlerësohen dhe numërohen fletët e votimit, nxirret rezultati për çdo njësi zgjedhore.
- Shqyrtohen ankime në KQZ dhe Kolegjin Zgjedhor
- Deklarohet rezultati përfundimtar i zgjedhjeve

Për të gjykuar për proçesin zgjedhor, në lidhje me nivelin e plotësimit të standardeve që zgjedhjet të konsiderohen të lira, të drejta dhe demokratike, vendet antare të OSBE-se kanë pranuar të përdorin si reference, vlerësimet që jepen në raportin përfundimtar për zgjedhjet, i cili hartohet nga Misioni i vëzhguesve ndërkombëtar të OSBE/ODIHR. Ndërkohë, krahas këtyre vlerësimeve dhe bashkë me to, OSBE/ODIHR rekomandon që të merren parasysh edhe vlerësimet dhe konsideratat që jepen për zgjedhjet, nga shoqëria civile, vëzhguesit e pavarur vendor. OSBE/ODIHR e konsideron vëzhgimin e zgjedhjeve nga vëzhguesit vendor si një faktor të rëndësishme dhe tregues cilësor për nivelin e zhvillimit të kulturës demokratike të shoqërisë. Ndaj dhe mbështetja për zhvillimin e kapaciteteve në komunitetet qytetare, për të monitoruar dhe vëzhguar proçeset zgjedhore, në të gjithë fazat, është një ndër angazhimet e përheshme të OSBE/ODIHR.

Në Shqipëri angazhimi i shoqërisë civile për monitorimin dhe vëzhgimin e zgjedhjeve filloi si një proçes bashkeshoqërues me proçeset e ndryshimeve në sistemin qeverisës dhe institucionalizimin pluralizmit politik, në fillim të viteve '90. Ndër vite angazhimet e shoqërisë civile shqiptare për të monitoruar dhe vëzhguar proçeset zgjedhore kanë patur si pjesë të pandarë të tyre përpjekjet për aftësimin profesional dhe zhvillimin organizativ të vëzhguesve vendor. Rezultatet e këtyre përpjekjeve

janë finalizuar me gjykimet dhe vlerësimet e dhëna në raportet përfundimtare për zgjedhjet e vëzhguara, të cilët kanë fituar cilësi profesionale përherë e më te mira.

Për herë të parë, vlerësimi për zgjedhjet, për nivelin e plotësisimit të standardeve, duke përdorur për këtë qëllim Indeksin e Integritetit të zgjedhjeve (IIZ), u realizua nga IDM, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, 2015. Vlerësimi i këtij indeksi, për të cilin u përdorën të dhënat e raportimeve me vlerësimeve, për fazat e ndryshme dhe çështje të ndryshme të procesit zgjedhor, të deklaruara nga organizata të ndryshme të shoqërisë civile, ishte një kontribut cilësisht i ri. Ai shënoi edhe fillimin e procesit të ndryshimeve cilësore në kontributin e shoqërisë civile për proceset zgjedhore në Shqipëri. Kjo përvojë, e parë në llojin e vetë, tërhoqi interesin e kërkuesëve shkencorë vendas dhe shërbeu si nxitje për kerkimin e rrugëve dhe mundësive për përdorimin e IIZ, si një tregues sasior domethënës për vlerësimin e proceseve zgjedhore në Shqipëri.

Indeksi që vlerëson Perceptimin për Integritetin e Zgjedhjeve (PEI) për zgjedhjet parlamentare të zhvilluar në Shqipëri në vitin 2013 dhe në vitin 2017, është vlerësuar nga Norris, P. et al., në kuadër të Electoral Integrity Project (2019), në të cilin janë analizuar 337 zgjedhje në 166 vende të ndryshme te botës. Vlera e këtij indeksi për Shqipërinë ka rezultuar 54 dhe 53, respektivisht për zgjedhjet e zhvilluara në vitin 2013 dhe ato të zhvilluara në vitin 2017.

Sipas këtyre vlerave, për të dy këto zgjedhje, Shqipëria klasifikohet në grupin e vendeve që kanë zhvilluar zgjedhje që, në tërësinë tyre, klasifikohen në nivelin "Të moderuara", e pozicionuar në fashën e ulët të vlerave që i takojnë këtij niveli (50-59).

Me mbështetjen e Ambasadës së Zvicrës, INSIZ u angazhua dhe realizoi vlerësimin e Indeksit të Integritetit të Zgjedhjeve, për zgjedhjet parlamentare që u zhvilluan në 25 prill 2021.

II. Indeksi i integritetit të zgjedhjeve (PEI)

Për të realizuar zgjedhje me integritet është e nevojshme që vendi të hartojë një kuadër ligjor dhe të ndërtojë një sistem institucional, të cilët të nxitin dhe të mbështetin zhvillimin e zgjedhjeve të lira, të drejta e demokratike. Zgjedhjet me integritet arrihen vetëm kur zbatimi i legjislacionit dhe sjellja e të gjithë aktoreve pjesëmarrës në procesin zgjedhor, partitë politike, administrata zgjedhore, institucionet ligjzbatuese dhe deri zgjedhësit, karakterizohen nga vullneti dhe angazhimi i tyre për të realizuar zgjedhje bazuar në standardet demokratike, trashëgiminë zgjedhore europiane, angazhimet e OSBE-se dhe praktikrat e mira zgjedhore. Ndër parime kryesore udhëzuese që ndihmojnë zhvillimin e zgjedhjeve me integritet mund të renditen:

- Respektimi i parimeve të demokracisë zgjedhore, ndër të cilët bëjnë pjesë:

(i) të gjithë qytetarët kanë të drejta të barabarta për të marrë pjesë në zgjedhje si votues dhe/ose kandidatë;

(ii) të gjithë qytetarët duhet të kenë të drejtë të barabartë për votimi;

(iii) për të gjithë duhet të sigurohet sekreti i votës;

(iv) votuesit duhet të kenë mundësi dhe akses të barabartë me informacionin zgjedhor dhe fushatën;

- (v) administrimi i zgjedhjeve duhet të kryhet në mënyrë të drejtë dhe jo partiake
- (vi) zgjedhjet duhet të zhvillohen rregullisht në periudha kohe të përcaktuara;
- (vii) rezultatet e zgjedhjeve duhet të vendosen nga votat e hedhura lirisht nga qytetarët.

Zgjedhje janë të lira kur qytetarëve, komuniteteve dhe ose grupimeve të tyre në parti politike ju sigurohet liria e fjalës, e mbledhjes, e organizimit, lëvizja e lirë dhe mungesa e frikës dhe e presionit.

Zgjedhje e ndershme mund të realizohen vetëm kur:

- (i) proces zgjedhor është transparent,
- (ii) legjislacioni, rregulloret dhe rregullat e ndryshme zgjedhore janë të barabarta për të gjithë,
- (iii) të gjithë kanë mundësi të barabarta për të marr pjesë pjesë në proces, si votues, administrator, vëzhgues ose kandidat,
- (iv) procesi zgjedhor administrohet nga komisione të pavarur dhe të paanshëm;
- (v) zgjedhësi nuk intimidohet,
- (vi) procedurat zbatohen nga të gjithë,
- (vii) respektohen rregullat dhe kufizimet që parashikon kuadri legjislativ ligjor e nënligjor,
- (viii) rezultati i shpalluar është pasqyrim real i vullnetit të zgjedhësve të shprehur me vote,
- (ix) rezultati pranohet.

• Sjellja etike

Integriteti në zgjedhje varet nga sjellja etike e administratorëve të zgjedhjeve, zyrtarëve të zgjedhjeve, kandidatët, partitë dhe të gjithë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor. Kjo nënkupton që të gjithë duhet të sillen në një mënyrë që promovon një proces të lirë dhe të ndërshtëm dhe që dekurajon sjelljet që i kundërvihen ligjit dhe që rrezikojnë integritetin e procesit

• Profesionalizmi, saktësia dhe korrektësia në zbatimin e ligjit

Kjo kërkon, në rradhë të parë që administrata zgjedhore të jetë profesionalisht e përgatitur, korrekte dhe me integritet në vendimarrje. Sjelljet me ngjyrim politike ose që krijojnë perceptimin se favorizojnë kandidatë ose subjekte të caktuara në garën elektorale, dëmtojnë, në mënyrë të ndjeshme integritetin e procesit zgjedhor.

• Angazhime profesionale të institucioneve

Zbatimi i kërkesave të ligjit nga institucionet ligjzbatuese që kanë detyra në kuadër të procesit zgjedhor dhe respektimi i detyrimeve dhe kushtëzimeve ligjor për institucionet që përcatohen në ligjin zgjedhor, janë faktorë të rëndësishëm për integritetin e zgjedhjeve.

• Mbikëqyrja dhe zbatimi

Në legjislacion parashikohen kërkesat për ngritjen dhe funksionimin e institucioneve përgjegjës për mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjeve zgjedhore nga administrata zgjedhore. Mbikëqyrja e vazhdueshme e procesit, nëpërmjet aktivizimit të mekanizmave të brendshëm dhe të jashtëm, ndihmon në zbulimin e problemeve në sistem dhe identifikimin e grupeve ose individëve përgjegjës. Aktivizimi i vazhdueshëm dhe përherë e më shumë efektiv i këtij procesi mbikqyrje është një përparësi e

rëndësishme për çrrënjosjen e korrupsionit nga procesi zgjedhor, për vendosjen e përgjegjësve para drejtësisë dhe realizimin e ndjenjës së besimit në sistem.

- Transparenca dhe përgjegjësia.

Transparenca i bën strukturat institucionale dhe veprimet / vendimet që ata marrin gjerësisht të aritshme dhe të kuptuara më mirë. Pjesëmarrësit në një zgjedhje zakonisht do të kenë më shumë besim nëse kanë qasje në informacionin e detajuar procedural dhe kur mund të kuptojnë se si funksionon procesi zgjedhor. Transparenca, së bashku me vëzhgimin publik, zakonisht sigurojnë motivime shtesë për administratorët zgjedhorë dhe zyrtarët e zgjedhjeve që të veprojnë në përputhje me rregullat dhe të jenë të përgatitur që të mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre.

III. Metodologjia

Vlerësimi i Perceptimeve për Integritetin e Zgjedhjeve është realizuar duke zbatuar, në linjat kryesore, rregullat e përshkruara në Metodologjinë e hartuar nga Norris, P. et al., (2014). Sipas kësaj Metodologjie, vlerësimi i Indeksit për Perceptimin e Integritetit të Zgjedhjeve, kryhet duke përdorur vlerësimin sasior të perceptimeve për 49 treguesve, të grupuar në 11 indikatorë, të cilët pasqyrojnë të gjithë ciklin zgjedhor (Fig. no.1).

Norris, P. et al (2014) thekson se vlerat e 49 treguesve (items) janë vlerësime sasiore të perceptimeve të ekspertëve që angazhohen për këtë qëllim. Çdo tregues formulohet në trajtën e një pohimi ndaj të cilit duhet të shprehet qëndrimi me senc rritje pozitiv, duke filluar nga vlera me e ulët (1) deri tek me e larta (5). Për vlerësimin e Indeksit të përgjithshëm të perceptimeve për integritetin e zgjedhjeve (PEI), vlerat e indikatorëve (mesatarja e vlerave të të gjithë treguesve përbërës të indikatorit përkatës) standartizohen në vlera nga 1 deri në 100 pikë.

Për vlerësimin e Indeksit PEI për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, 26 prill 2021, mbështetur në Metodologjinë e më sipërme, INSIZ aktivizoi 10 specialistë, me formim në shkencat juridike dhe politike. Duke mbajtur parasysh veçoritë dhe problemet që kanë shoqëruar proceset zgjedhore në Shqipëri, ndër të cilat veçohen problemet që lidhen me hartimin e legjislacionit, rregjistrimin e kandidatëve dhe detyrimin ligjor për vetdeklarim në zbatimin e ligjit për pastërtinë e figures (ligji i dekriminalizimit), fushatës zgjedhore dhe financimit të saj, përfaqësimit gjinor, administrimit të procesit zgjedhor, për vlerësimin i indeksi PEI, në përputhje me Pippa, N.. et al, u përdoren të dhënat e perceptimet për 11 indikatorë. Për secilin prej këtyre indikatorëve u hartua lista e treguesve, numri i të cilëve, jepet në Tab. No. 2.

Ndryshe nga Norris, P. et al., numri i treguesve që u morën në konsideratë për vlerësimin e Indeksit të integritetit të zgjedhjeve, 25 prill 2021, është ndjeshëm më i madh, 147 vs 49. Këto ndryshime u bënë me qëllim që vlerësimi sasior i perceptimeve të mbështetet në një informacion, i cili të pasqyrojë, në mënyrë sa më të detajuar, fazat e procesit zgjedhor që vëzhgohen, procedurat dhe nivelin e zbatimit të tyre në secilin prej këtyre fazave, duke ju referuar specifikave dhe veçorive që kanë karakterizuar proceset zgjedhore në Shqipëri. Detajimi dhe formulimi i treguesve u bë duke patur parasysh metodologjinë që përdoret nga vëzhguesit e pavarur vendor shqiptar, për vëzhgimin e proceseve zgjedhore. Në formulimin e treguesve u mbajtë parasysh mënyra se si janë formuluar pyetjet në Pytësoret që

përdoren nga keta vëzhgues. Në këtë mënyrë, u krijua mundësia që, për vlerësimin e Indeksit PEI të përdoret edhe informacioni dhe të dhënat që janë publikuar në raportet e ndërmjetme dhe raportet përfundimtare për vëzhgimin e zgjedhjeve, nga vëzhguesit e pavarur vendor shqiptar.




Fig. no. 1 Indeksi i integritetit të zgjedhjeve – cikli zgjedhor

Source: Electoral Integrity Project. 2014. *The expert survey of Perceptions of Electoral Integrity, Release 2.5 (PEI-2.5)*.

PEI index

≤ 40 pikë	Shumë i ulët
40 ⁺ - 50 pikë	I ulët
50 ⁺ - 60 pikë	I moderuar
60 ⁺ - 70 pikë	I lartë
≥70 ⁺ pikë	Shumë i lartë

Table no. 2 Indikatorët dhe numri i treguesve

Faza	Indikator	Numri i treguesve
Para ditës së zgjedhjeve	Legjislacioni zgjedhor	12
	Proçedurat elektorale	15
	Zonat zgjedhore	5
	Lista e zgjedhësve	7
	Regjistrimi i subjekteve	17
Fushata	Media dhe fushata	18
	Fushata-financimi	17
Dita e votimit	Proçesi i votimit	17
Pas ditës së votimit	Vlerësimi dhe numërimi i votave	12
	Rezultati	8
	Administrata zgjedhore	19

IV. Vlerësim i indikatorëve

1. Kuadri ligjor

Ligji zgjedhor duhet të gëzojë mbështetje sa më të gjerë nga subjektet e interesuara në proces, partitë politike, kandidatët dhe zgjedhësit. Për këtë arsye ai duhet të jetë produkt i një procesi legjislativ gjithëpërfshirës. Sipas Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venencies, ndryshimet të Kodin Zgjedhor duhet të bëhen, të paktën, gjatë muaj përpara ditës së zgjedhjeve.

Si rregull, në Shqipëri ndryshimet në Kodin zgjedhor janë realizuar si një proces bipartisan, i cili nuk e ka respektuar rekomandimin e dhënë në Kodin e Praktikave të Mira në Çështjet Zgjedhore, për kohën kur ato duhet të bëhen. Shpesh këto ndryshime kanë qënë rezultat i dakortësisë bipartizane të arritur në prag të fillimit të procesit zgjedhor.

Për të gjykuar dhe vlerësuar procesin legjislativ që u zhvillua për zgjedhjet parlamentare, 25 prill 2021 dhe produktin e tij, Kodin Zgjedhor, INSIZ organizoi vëzhgimin e këtij procesi menjëherë pas ngritjes nga Kuvendi i Shqipërisë, me vendimin nr. 102/2017, të Komisionit parlamentar për reformën zgjedhore.

Rezultatet e përpunimit të të dhënave për perceptimet dhe vlerësimin e këtij procesi legjislativ, jepen në tabelën no. 3.

Tabela no. 3 Vlerësimi për indikatorin “Legjislacioni - Kodi zgjedhor”

Indikator		Vlerësim 1 deri 5
PËRPARA DITËS SE ZGJEDHJEVE	1. Legjislacioni - Kodi zgjedhor	
	1.1 Reforma zgjedhore ishte konsensuale	2.2
	1.2 Ndryshimet në Kodin zgjedhor pasqyruan rekomandimet e OSBE/ODIHR	3.0
	1.3 Kodi zgjedhor i plotëson standardet ndërkombëtare dhe siguron në mënyrë adekuate respektimin e të drejtave fundamentale të njeriut.	3.7
	1.4 Kodi zgjedhor krijoi mundësi reale për votimin nga jashtë territorit të vendit	3.1
	1.5 Kodi zgjedhor është i qartë dhe nuk mund të keq interpretohet.	3.8
	1.6 Kodi zgjedhor jep garanci të mjaftueshme për respektimin e të drejtave civile dhe politike	4.3
	1.7 Kodi zgjedhor nuk diskriminon partitë e vogla	2.0
	1.8 Kodi zgjedhor nuk diskriminon kandidatët e pavarur	2.0
	1.9 Kodi zgjedhor nuk favorizon partinë ose partitë qeverisëse	1.8
	1.10 Kodi zgjedhor nuk i diskriminon pakicat kombetare	3.2
	1.11 Kodi zgjedhor mbështet barazinë gjinore	4.8
1.12 Udhëzimet e KQZ pasqyrojnë kërkesat e Kodit zgjedhor	4.1	
	3.17	(54.25)

Reforma zgjedhore për përgatitjen e kuadrit ligjor për zgjedhjet parlamentare, 25 prill 2021, u zhvillua si një proces ku mbizotruan mosmarrveshjet midis palëve, mazhorancë e opozitë. Presioni ndërkombëtar rezultoi si faktori më kryesor shtytës në të gjithë këtë proces. Rezultat i tij ishte miratimi i Ligjit nr. 101/2020, datë 23.7.2020 “Për ndryshimet në Kodin zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”, i cili ktheu në akt ligjor Marrveshjen e 5 qershorit 2020, të arritur në Këshillin politik, midis mazhorancës dhe opozitës së bashkuar jashtëparlamentare. Miratimi i ndryshimeve në Kushtetutën e

Shqipërise dhe i ndryshimeve në Kodin zgjedhor, ligji nr. 118/2020, datë 5.10.2020, nga mazhoranca bashkë me opozitën parlamentare, pa dakortësinë e opozitës së bashkuar jashtëparlamentare, ishte një veprim që ju kundërvu, në mënyrë esenciale, kërkesës dhe standardit për të realizuar reformë zgjedhore konsensuale.

Ndryshimet e bëra në Kodin zgjedhor krijuan një terren legjislativ më mbështetës për zhvillimin e një procesi zgjedhor në përputhje dhe zbatim të standardeve për zgjedhje demokratike dhe angazhimeve të OSBE-së. Përfshirja në Kodin zgjedhor e dispozitave që rregullojnë përdorimin e teknologjisë së informacion për identifikimin biometrik të zgjedhesve, dispozitat që trajtojnë kërkesën për rritjen e transparencës dhe monitorimin e shpenzimeve për fushatën zgjedhore, për mos përdorimin e aseteve publike në funksion të fushatës zgjedhore, për rritjen e presionit ndaj administratës zgjedhore për zbatimin e ligjit dhe procedurave ligjore, ndryshimet për funksionimin me efektiv të drejtësisë zgjedhore dhe për zbatimin e parimit të barazisë gjinore, janë ndër arritje legjislative që e mbështetin këtë vlerësim.

Megjithë deklaratimet e bëra nga partitë politike për pasqyrimin e rekomandimeve të misioneve të vëzhguesve ndërkombëtar të OSBE/ODIHR, në Kodin zgjedhor të ndryshuar nuk u arrit të realizohen plotësisht pritshmëritë. Në veçanti, nuk u ndryshua parimi sipas të cilit duhet të ndërtohet administrata zgjedhore. Rekomandimi për ndërtimin e një administrate jo mbi bazën e parimit të përfaqësimit politik, nuk u pasqyrua në ndryshimet e bëra në Kodin zgjedhor.

Në Kodin zgjedhor u përfshinë, për herë të parë, dispozita për votimin nga jashtë territorit të vendit. Megjithë këtë, Kodi zgjedhor e trajton këtë çështje vetëm në linjat kryesore dhe si një mundësi për zgjedhjet e 25 prillit 2021. Ai ngarkon KQZ të hartojë dhe të implementojë të gjithë kuadri nënligjor të nevojshëm dhe të ndërtojë infrastrukturën që do të shërbente për realizimin e votimit nga jashtë territorit të vendit.

Në refomën zgjedhore nuk u trajtua problemi i ndryshimeve në sistemin zgjedhor. Partitë kryesore, PS, PD e LSI nuk treguan vullnet as për të zvogëluar numrin e njësisve zgjedhore. Ndryshimet në Kushtetutë, te cilat hoqën dispozitën që kushtëzonte ndarjen e vendit në njësi zgjedhore duke ju referuar ndarjes territoriale administrative te vendit dhe trajtimit i këtij problemi vetëm në Kodin zgjedhor, e krijuan këtë mundësi. Mos ndryshimi, zvoglimi i numri i njësisve zgjedhore, diskriminoi partitë vogla dhe partitë e reja. Ai favorizoi ndjeshëm partitë e mëdha, PS e PD.

Vendosja në Kushtetutë e pragut elektoral kombëtar, i cili në Kodin zgjedhor u përcaktuar 1 përqind, është një kushtëzim që nuk harmonizohet me sistemin proporcional rajonal. Ky ndryshim ligjor favorizon partitë e mëdha. Është kusht shumë shtrëngues për partitë e vogla dhe aspak mbështetës për partitë e reja politike. Pragu kombëtar i zbatuar edhe për kandidatët e pavarur, që garojnë vetëm në një njësi zgjedhore, nuk ka sens llogjik. Ai bie ndesh dhe penalizon ndjeshëm parimin e garës me kushte të barabarta midis subjekteve zgjedhore.

Si përfundim, mbështetur në të dhënat e mësipërme, mund të pohohet se **indikator i pasqyron procesin e përgatitjes së kuadrit ligjor dhe cilësitë që zotron Kodi zgjedhor i reformuar, në zbatim të të cilit u zhvilluan zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë më 25 prill 2021, vlerësohet në nivelin "I moderuar"**. Në krahasim me vlerësimin për këtë indikator për zgjedhjet e zhvilluara në maj 2015, vlera e tij është rreth 13.2% më e ulët. Duke qënë se, në fakt Kodi i ri zgjedhor, si u

demonstrua edhe më sipër, në disa aspekte të rëndësishme të tij u përmirësua ndjeshëm në krahasim me Kodin sipas të cilit u zhvilluan zgjedhjet e vitit 2015, diferenca e mesipërme është pasojë e faktit se procesi legjislativ u shmang, në mënyrë të ndjeshme, nga cilësia për të qënë konsensual.

2. Zbatimi i procedurave elektorale

Në përputhje me ndryshimet ligjore KQZ u formatua si një institucion me një komponente monokratike, Komisioneri shtetror dhe dy struktura kolegjal, antarë e të cilit zgjidhen në bazë të një gare midis kandidatëve. Ky ndryshim u bë me synim funksionimin më efektiv dhe më shumë transparent të tij. Megjithë këtë, duhet të theksohet se, pavarësisht nga ky ndryshim, zgjedhja e antarëve të këtij komisioni, e rregulluar me dispozita kalimtare në Kodin zgjedhor, u bë në bazë të po të njëjtit parim si edhe më parë, përfaqësimit politik. Efekti i mos ndryshimit të këtij parimi ndikoi në krijimin e perceptimit se, vendimmarrja e KQZ mund të ndikohej nga efekti që shkakton përzgjedhja politike e antarëve të tij.

Komisioneri shtetror, në zbatim të kërkesave të Kodit zgjedhor në përgjithësi tregoi profesionalizëm dhe nivel të lartë të transparencës. Me inisiativën e tij, për herë të parë në vendin tonë, u institucionalizua bashkëpunimi efektiv midis këtij institucioni dhe organizatave të shoqërisë civile, të angazhuara në monitorimin dhe vëzhgimin e proceseve zgjedhore dhe mbrojtjen e të drejtave politike të njeriut. Konsultimi paraprak me këto organizata, për aktet që shqyrtonte dhe që ka miratuar Komisioneri shtetror në përgatitje të procesit zgjedhor, ishte një praktike pune, e cila krijoi një kulturë të re pune në këtë institucion dhe në bashkëpunimin e tij me të tjerë.

Në punën për përgatitjen e akteve të ndryshme, të nevojshme për administrimin e procesit zgjedhor, Komisioneri i kushtoi vemendje marrjes së mendimit dhe konsultimit me partitë politike. Pavarësisht nga vlera që ka dhe fryma që përcjell një veprim i tillë, jo gjithmonë ishte i justifikueshëm dhe jo në çdo rast prodhoi efekte pozitive. Efektet e kësaj sjellje, në parim e pakritikueshme, u shfaqen në veçanti në vendim të Komisionerit për hartimin e fletës së votimit. U shpenzuar shumë kohë për konsultimin me partitë politike për këtë çështje. Kjo bëri që KQZ të kishte pak kohë për informimin e zgjedhësve për mënyrën se si duhet të administrojnë votën e tyre për subjektet dhe kandidatët. Pasoja e kësaj është numri shumë i madh i votave të pavlefshme.

Megjithëse Komisioneri urdhëroi që në Tetor, 2020, ngritjen e grupit të punës për votimin e shtetasve nga jashtë territorit të vendit, kjo mënyrë votimi, e parashikuar në ndryshimet e bëra në Kodin zgjedhor, nuk arriti të realizohej. Justifikimi se partitë politike nuk u angazhuan dhe nuk treguan vullnete mbështetëse për të realizuar këtë mënyrë votim, nuk mjafton. Në plotësim të detyrës Komisioneri duhet të kishte përgatitur të gjithë aktet nënligjore të nevojshme dhe t'i kërkonte Komisionit rregullator t'i shqyrtonte dhe miratonte ato.

Vendimi i Komisionerit për përcaktimin e numrimit të kandidatëve në listat shumë emrore të subjektet zgjedhore ishte pasojë e zbatimit jo korrekt të Kodit zgjedhor..

Hartimi i kuadrit nënligjor për përdorimin e teknologjisë së informacioni, organizimi, puna përgatitore dhe administrimi në zbatimin e kësaj teknologjie, si një përgjegjësi direkte e nënkomisionerit shtetror, megjithëse pati një numër qendra votimi, rreth 200 QV ose rreth 3.8%, ku

nuk u arrit të përdorej kjo teknologji, në përgjithësi u realizua në përputhje me ligjin dhe në nivelin e pritshmërive.

Tabela nr. 4 Vlerësimi për indikatorin "Zbatim i procedurave zgjedhore"

Indikator		Vlerësim 1 deri 5	
PËRPARA DITËS SE ZGJEDHJEVE	2. Proçedurat elektorale		
	2.1 Komisioneri shtetror mori vendime në përputhje me Kodin	4.0	3.13 (53.25)
	2.2 Komisioni rregullator mori vendime në përputhje me Kodin	3.2	
	2.3 KAS mori vendime në përputhje me Kodin	2.8	
	2.4 Kolegji zgjedhor mori vendime në përputhje me Kodin	3.1	
	2.5 KZAZ zbatuan gjithmon Kodin zgjedhor	4.5	
	2.6 KQV zbatuan gjithmon Kodin zgjedhor	3.9	
	2.7 Forcat e rendit e respektuan Kodin zgjedhor	4.0	
	2.8 Zgjedhësit u informuan rregullisht për procedurat e votimi	3.3	
	2.9 Zgjedhësit u informuan për qendren e votim	1.0	
	2.10 Zgjedhësit u informuan për ushtimin e të drejtës për votë parapëlqyese	2.8	
	2.11 Zgjedhësit u informuan për pasojat që sjell shkelja e Kodi zgjedhor dhe shirblerja e votës	2.9	
	2.12 Zgjedhësit e pakicave kombëtare u informuan në gjuhen e tyre amtare	2.0	
	2.13 Zgjedhjet u zhvilluan në përputhje me ligjin	3.4	
	2.14 Subjektet zgjedhore respektuan ligjin	2.7	
2.15 Partitë politike nuk ushtruan presion ndaj komisionerve	3.4		

Komisioneri shtetror shqyrtoi të gjithë rastet e denoncimit të shkeljeve të dispozitave të Kodit zgjedhor dhe udhëzimit të Komisionit rregullator, në lidhje me përdorimin aseteve publike dhe veprimtarive të institucioneve publike në fushatë, duke marr edhe vendime përkatëse. Nga 95 denoncime për përdorimin e burimeve shtetërore, Komisioneri Shtetëror mori vendime për 43 prej tyre: 3 masa administrative gjobë; 5 njoftime për marrje masash; 24 çështje të përfunduara pa konstatim shkelje; 11 çështje për mosfillim procedure.

Komisioneri nuk i kushtoi vëmëndje të dedikuar dhe sipas kërkesave të ligjit, shqyrtimit të njoftimeve të institucioneve publike për veprimtaritë e tyre gjatë fushatës. Komisioneri shtetror nuk arriti të përdorte, në mënyrë efektive, mekanizmat që i ofron ligji për të parandaluar dhe/ose dënuar përdorimin e aseteve dhe veprimtarive publike në funksion të fushatës zgjedhore.

Komisionerin nuk arriti të realizonte pritshmërinë e parashikuara për monitorimin, në kohë reale, të shpenzimeve që bënë subjektet politike dhe kandidatët e tyre për aktivitete të fushatës. Në plotësim të detyrave që rrjedhin prej ligjit për pastërtinë e figurës së të zgjedhurve (ligji për dekriminalizim) Komisioneri shtetror, menjëherë pas miratimit të listave të kandidatëve, organizoi procesin e verifikimit të vetdeklarimeve të tyre..

Komisioneri shtetror planifikoi dhe realizoi fushatën për edukimin e zgjedhësve duke përfshirë zgjedhësit që votojnë për herë të parë dhe shtresat e cënueshme të popullatës. Gjatë kësaj fushate ju kushtua vend i veçant problemeve që lidhen me shitblerjen e votës, penalitetet që shkakton shkelja e Kodit zgjedhor, mënyrës së votimit, identifikimit biometrik të zgjedhësve etj. Megjithë këtë, efektet e kësaj fushate nuk u arritën në përputhje me objektivat. Në veçanti, përdorimi i votës parapëlqyese

nuk u administrua mirë nga zgjedhësit, duke e rritur shumë numrin e votave të pavlefshme. Trajnimi i teknikëve që do të përdornin pajisjet elektronike jo në çdo rat ishte efektiv.

Në bashkepunim me AMA komisioneri shtetror monitoroi zbatimin e Kodit zgjedhore për mediat në fushatën zgjedhore. Ndërkohë duhet të theksohet se plotësimi i kësaj detyre nga Komisioneri shtetror, nuk e kaloi kufirin e zbatimit formal të ligjit.

Për zgjedhësit që ju përkasin pakicave kombëtare nuk u hartua dhe nuk u zbatua një plan veprimi, i shtrirë në territoret ku banojnë keto komunitetet, për informimin dhe edukimin e tyre në gjuhën amtare. Në pjesën më të madhe të rasteve KQZ-ja u mjaftua me përcjelljen online të informacion për edukim dhe informim të këtyre zgjedhësve.

Komisioneri në bashkepunim edhe me organet e qeverisjes vendore nuk arriti të siguronte, në çdo rast, qendra votimi lehtësisht të aksesueshme për votuesit me aftësi të kufizuar. Për votuesit e verbër nuk u krijuan mundësitë për të votuar me fletë votim të posaçme (Shkrimi Braille).

Informimi i publikut, në kohë reale, për ecurinë pjesëmarrjes në votime është një detyre e porealizuar nga Komisioneri shtetror.

Informimi i publikut për rezultatet progresive në procesin e vlerësimit dhe numërimit të vota i shërbeu transparencës së këtij procesi.

Komisioni rregullator, si organi kompetent për miratimin e akteve me karakter normativ në fushën e zgjedhjeve dhe vendosjen e rregullave për zgjedhjet, miratoi 34 vendime, për të cilat votuan pro të paktën 4 antare të tij. Pjesë e vendimeve të Komisionit rregullator ishin dhe materialet që u përdoren për trajnimin profesional të komisionerve dhe grupeve të numërimit të votave.

Pati vendime që Komisioni rregullator nuk arriti kuorumin e nevojshme për t'i miratuar, si ishte projektvendimi "Për miratimin e përmbajtjes së fletëve të votimit" për të cilin Komisioni deklaroi moskompetencën e tij.

Komisioni rregullator nuk mori në shqyrtim asnjë akt të lidhur me mundësinë e votimit nga jashtë territorit të vendit.

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, i shqyrtoi në kohë të gjithë ankimet e bëra gjatë periudhës parazgjedhore dhe pas zgjedhjeve, gjithsej 24 kërkesa ankimore të bëra nga subjekte zgjedhore, parti politike, koalicion ose OJF të ndryshme. KAS shqyrtoi dhe mori vendime për të gjithë ankimet e bëra nga subjekte zgjedhore për shpallje të pavlefshmërisë dhe përsëritjen e zgjedhjeve. Gjatë shqyrtimit administrativ të tyre KAZ, me tre vota pro, nuk pranoi kërkesën e ankimuesve për të marr informacion nga institucione të tjera. Në përgjithësi vendimet u morën me shumicën e thjeshtë të antarëve të këtij komisioni. Në funksion të vendimmarrjes se tij KAS administroi vetëm materialet zgjedhore. Ky qëndrim i KAS ndaj kërkesave të ankimuesveve u vlerësua prej tyre si qëndrim me prapavije politike, i nxitur dhe i kërkuar nga Partia Socialiste.

Kolegji zgjedhor i gjykatës se apelit para ditës se zgjedhjeve shqyrtoi tre kërkesa për rishikim të vendimeve të marra nga KAS dhe pas ditës se zgjedhjeve në këtë institucion u shqyrtuan gjithsej 9

kërkesa. Kolegji zgjedhor i gjykoj kërkesëpaditë e subjekteve zgjedhore, të bëra para ditës së zgjedhjeve, në mënyrë të paanëshme. Proçesi i shqyrtimit të ankimimeve prej Kolegjit Zgjedhor u krye në përputhje me afatet kohore.

Vendimet e Kolegjit zgjedhor për paditë për pavlefshmërinë e rezultatit të zgjedhjeve nuk u pranuan nga partitë e opozitës. Ato deklaruan vazhdimin e përpjekjeve për gjykim të këtyre padive në Gjykatën kushtetuese ose edhe në gjykata ndërkombetare

KZAZ, e administruan proçesin e përgatitjes së zgjedhjeve, ditën e zgjedhjeve, numërimin e votave dhe tabelimin e rezultatit, në përgjithësi në mënyrë të rregullt dhe në respektim të Kodit zgjedhor. Në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore, KZAZ-të hartuan hartën e shpërndarjes, në territorin përkatës të ZAZ, të vendndodhjeve të qendrave të votimit dhe vendin e numërimit të votave, mbikqyrën proçesin e përgatitjes dhe përshtatjes së QV-ve, organizuan vendin e numërimit të votave, morën vendime për ngritjen e komisioneve të qendrave të votimit, organizuan punën për infomimin dhe edukimin e zgjedhësve, për trajnimin e komisionerëve dhe antarëve të grupeve të numërimit dhe gjithë detyrat e tjera të përcaktuara në udhëzimet e KQZ.

Zëvendësimi i antarëve të KZAZ-ve, KQV-ve, GNV-ve ndikoi negativisht në zhvillimin normal të proçesit të trajnimit të tyre. Për pasojë, anëtarët e këtyre komisione kishin njohuri të kufizuara në lidhje me dispozitat e Kodit të ri Zgjedhor. Veçanërisht më e theksuar ishte kjo në rastin e antarëve të KQV-ve..

Përkatësia politike e antarëve të KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-e, në disa raste ndikoi negativisht në administrimin e proçesit zgjedhor. Veçanrisht gjatë proçesit të numërimit të votave dhe hartimit të tabelës së rezultateve ky fenomen ishte më prezent.

Vlera mesatare e standartizuar e **indiktorit që pasqyron zbatimin e proçedurave zgjedhore prej administratës zgjedhore dhe efekteve të tyre, 54.5 pikë, tregon se në zgjedhjet parlamentare 25 prill 2021, ky indikator përbërës i indeksit të integritetit të zgjedhjeve, vlerësohet në nivelin “I moderuar”** Në krahasim me zgjedhjet parlamentare të zhvilluara në vitin 2013 dhe 2017 (Pippa, N. et al., 2019), vlera e këtij indikator është më e ulët, respektivisht rreth 16.1% dhe 14.8%

3. Ndarja e zonave zgjedhore

Në Kodin e Praktikave të Mira për Çështjet zgjedhore theksohet se kufijtë e zonave zgjedhore dhe shtrija gjeografike e tyre në territor është e rëndësishme për cilësinë e zgjedhjeve. Ato mund të ndikojnë në rezultatin e zgjedhjeve dhe për pasojë edhe në proçeset politike dhe institucionet që dalin prej tyre. Në përgjithësi, mazhorancat qeverisëse janë të prirura që të ndërtojnë hartën e shpërndarjes në territor të njëjësive zgjedhore, në funksion të interesit të tyre electoral, duke anashkaluar interesin e zgjedhësve, në veçanti duke rritur mundësitë e tyre për t'u përfaqësuar dhe duke mos respektuar parimin për fuqinë dhe barazinë propocionale të votës.

Duke ju referuar rezultateve të zgjedhjeve parlamentare të zhvilluara pas ndryshimit të sistemit zgjedhor dhe kalimit në sistem propocional rajonal, me 12 njësi zgjedhore, koresponduese të dymbëdhjetë qarqeve, në Shqipëri u artikulua, përherë e më shumë, kërkesa për ndryshimin e sistemit,

pjesë e të ciles ishte edhe kërkesa për zvogëlimin e numrit të njërive zgjedhore dhe ndryshimin e kufijve të tyre.

Ndryshimet kushtetuese krijuan mundësinë për trajtimin e kësaj kërkesë. Partitë kryesore politike, PS, PD e LSI nuk u angazhuan për zgjidhjen e saj. Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, 25 prill 2021 u zhvilluan në 12 njësi zgjedhore, pa bërë asnjë ndryshim në kufijtë e tyre.

Për të vlerësuar efektin e ndarjes së zonave zgjedhore në Indeksin e integritetit të zgjedhjeve, u përdoren të dhënat e perceptimeve për pesë items (Tabela nr. 5)

Perceptimet për efektin e mënyrës së ndarjes në zona zgjedhore të vendit, në integritetin e zgjedhjeve, evidentojnë faktin se, ndarja në 12 njësi zgjedhore dhe vendosja e pragut kombëtar, megjithëse

Table no. 5 Vlerësim i indikatorit "Ndarja e zonave zgjedhore"

Indikator		Vlerësim 1 deri 5	
PËRPARA DITËS SË ZGJEDHJEVE	3. Ndarja e zonave zgjedhore		
	3.1 Ndarja e zonave zgjedhore nuk i diskriminon partitë politike	3.1	2.14 (28.50)
	3.2 Partitë e vogla dhe të partitë e reja nuk diskriminohen nga ndarja e zonave zgjedhore	2.0	
	3.3 Ndarja e zonave nuk ndikon në fuqinë e votës	3.3	
	3.4 Pragu kombëtar nuk diskriminon partitë e vogla dhe kandidatët e pavarur	1.3	
	3.5 Pragu kombëtar nuk diskriminon kandidatët e pavarur	1	

sistemi i zgjedhjeve është propocional rajonal, ndikojnë negativisht. Një ndarje e tillë i diskriminon partitë e vogla dhe partitë e reja politike. Kjo ndarje perceptohet si faktor me efekt negativ në fuqinë e votës dhe pragu kombëtar konsiderohet si një kushtëzim ligjor që, në mënyrë të vecantë i vendos në pozita plotësisht të pabarabartë gare, partitë e vogla dhe kandidatët e pavarur, në krahasim me partitë e medha, PS e PD.

Vlera mesatare e konvertuar e këtij indikator (28.5 pikë) e klasifikon atë në nivelin "shumë i ulët", duke e identifikuar atë si një faktor me efekt të rëndësishëm negativ në perceptimin për integritetin e zgjedhjeve

4. Lista e zgjedhësve

Çdo shtetas shqiptar, që ka mbushur moshën 18 vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve ka të drejtën e votës. Edhe pse kufizimi i të drejtës së votës për personat e shpallur me vendim gjykatë si të pazotë për të vepruar është hequr nga neni i Kodit Zgjedhor mbi kriteret për përfshirjen e zgjedhësit në listat e zgjedhësve, ai vazhdon të qëndrojë në nene të tjera (të Kodit) dhe në Kushtetutë. Kodi zgjedhor përcakton se shtetasit që janë duke kryer një dënim me burg për kryerjen e veprave të caktuara penale nuk mund të votojnë.

Me ndryshimet që u bënë në Kodin zgjedhor me ligjin nr 101/2020, datë 23.7.2020, për herë të parë në Shqipëri u parashikua edhe mundësia për votim nga jashtë vendit. Kodi ngarkon KQZ të përgatit të gjithë kuadrin nënligjor të nevojshme për realizimin e kësaj mënyrë votimi. Zgjedhësi mund të

votojë në këtë mënyrë vetëm në se është i rregjistruar në Listën e zgjedhësve që do të votojnë nga jashtë territorit të vendit.

Organet e pushtetit vendor, zyrat e gjendjes civile janë përgjegjëset për hartimin e listës së zgjedhësve. Sistemi i regjistrimit të zgjedhësve është pasiv. Votuesit mbi moshën 100 vjeç hiqen automatikisht nga lista e zgjedhësve dhe duhet të konfirmojnë të dhënat e tyre për t'u futur sërish në lista. Listat e zgjedhësve mbështeten në bazën elektronike të të dhënave të Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile, e cila mirëmbahet nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC) pranë Ministrisë së Brendshme.

Legjislacioni parashikon pjesëmarrjen e zgjedhësve në procesin e korrigjimit të listës paraprake. Duke filluar nga 3 tetori 2020, Zyrat e Gjendjes Civile publikuan çdo muaj ekstrakte të listës së

Tabela nr. 6 Vlerësimi për indikatorin "Lista e zgjedhësve"

Indikator		Vlerësim 1 deri 5		
PËRPARA DITËS SË ZGJEDHJEVE	4.Lista e zgjedhësve			
	4.1 Kuadri ligjor për regjistrimin e votuesve mundeson hartimin e një listë të saktë	4.8	3.76 (68.93)	
	4.2 Lista e zgjedhësve është publike dhe lehtësisht e aksesueshme	4.8		
	4.3 Korrigjimi i gabimeve dhe pasaktësive në listë është plotësisht i mundshëm nga qytetaret	4.7		
	4.4 Kuadri ligjor për regjistrimin në listën e zgjedhësve me një vendim gjyqi është i qartë dhe i lehtë për t'u përdorur nga qytetaret	3.9		
	4.5 Ndryshimet i qendes se votimit nuk solli shqetësim të zgjedhësit	2.1		
	4.6 Organet e qeverisjes vendore i njoftuan zgjedhësit për qendren e votimit	1.2		
	4.7 Partitë politike kishin akses të plotë me procesin e hartimit të listës së zgjedhësve	4.8		

zgjedhësve, për shqyrtim publik. Kodi detyron organet e qeverisjes vendore të njoftojnë, me shkrim, derë më derë, zgjedhësit për numrin e qendrës së votimit dhe numrin e tyre në listën e zgjedhësve të kësaj qendre.

KQZ-ja mbikqyri procesin e përpilimit të listës së zgjedhësve. Partitë politike kanë të drejtë të monitorojnë procesin e hartimit të listës së zgjedhësve. Këtë e realizojnë nëpërmjet audituesve, të emëruar nga KQZ, të cilët propozohen prej partive politike

Rregjistrimi në listën e zgjedhësve është kusht i domosdoshëm për të ushtruar të drejtën e votës.

Për vlerësimin e perceptimeve në lidhje me efektin e listës së zgjedhësve në Indeksin e integritetit të zgjedhësve, u përdorën të dhënat e grumbulluara për treguesit e listuar në Tablen nr. 6

Mbështetur në këto perceptime mund të pohohet se, në përgjithësi lista e zgjedhësve, si një ndër faktorët e rëndësishme për integritetin e zgjedhësve në Shqipëri, vlerësohet se ka gjeneruar efekte pozitive. **Ky indikator vlerësohet në nivelin "I lartë"**. Kjo është rrjedhojë e faktit se aktualisht, në Shqipëri për hartim e listës së zgjedhësve përdoret një legjislacion i përafëruar me kërkesat e dokumentave ndërkombëtar dhe me legjislacionin e vendeve të BE-se. Proçesi për hartimin e listës

se zgjedhësve është i hapur për pjesëmarrjen e qytetarëve dhe transparent, procedurat për korrigjimin e listës së zgjedhësve janë të thjeshta dhe të kuptueshme.

Megjithë këtë, në cilësinë e procesit për hartimin e listës së zgjedhësve vlerësohet negativisht mungesa e angazhimit të organeve të qeverisjes vendore për njoftimin e zgjedhësve për qendrën e votim dhe ndyshimet e bëra në numrin e qendrës së votimit, për një numër jo të vogël zgjedhësish, pa u informuar këta të fundit.

Cilësia e listës së zgjedhësve u reflektua edhe në numrin e vogël të zgjedhësve që u paraqitën në qendrën e votimit dhe nuk arritën të votonit sepse nuk kishin emrin në listën e zgjedhësve të qendrës përkatëse. Ndërkohë është e rëndësishme të theksohet, se në raste të tilla, duke përdorur mundësitë e teknologjisë së informacionit për identifikimin biometrik të zgjedhësve, komisioni i qendrës së votimit, në shumë raste, i tregoi këtyre zgjedhësve numrin e qendrës së votimit ku duhet të shkonin për të votuar.

5. Rregjistrimi i subjekteve zgjedhore

Në përputhje me afatin e përcaktuar në Kodin zgjedhor, Komisioneri shtetror rregjistroi partitë politike që paraqitën kërkesën për të garuar në zgjedhjet e 25 prillit 2021. Komisioneri rregjistroi edhe kërkesat e paraqitura nga grupe zgjedhësisht për t'i pajisur me dokumentacionin që kërkohet për regjistrimin e kandidatëve të pavarur. Rregjistrimi i subjekteve zgjedhore u krye në përputhje me kërkesat e Kodit zgjedhor.

Në Kodin zgjedhor është rikonsideruar mundësia e garës me koalicion, duke e trajtuar këtë mundësi në përputhje me kërkesat e Kushtetutës të ndryshuar. Rregjistrimi i koalicioneve u krye në përputhje e përcaktimet e dhëna në Kodit zgjedhor.

Çdo zgjedhës me të drejtë vote ka të drejtë të kandidojë, përveç atyre që vuajnë aktualisht një dënim me burg ose që kanë qenë të dënuar më parë për vepra penale specifike. Në Kushtetutë janë përcaktuar kategoritë e zyrtarëve, veprimtaria e të cilëve është e papajtueshme me të drejtën për të kandiduar. Këto kërkesa të ligjit u respektuan nga partitë politike dhe KQZ-ja.

Partitë politike, koalicionet dhe grupet nismetare të qytetarëve i paraqitën Komisionerit shtetror listat e kandidatve për secilën nga 12 njësitë zgjedhore. Në këto lista vetëm kyetarët e partive mund të rregjistroheshin në më shumë se një listë. Këtë të drejtë ligjore e përdoren PS, PD dhe LSI, kryetarët respektiv të të cilëve u rregjistruan, secili në dy njësi zgjedhore. Komisioneri shtetror, duke interpretuar kërkesën e Kodit zgjedhor për numrin e kandidatëve në listën shumë emerore dhe respektimin e kuotës gjinore, i ktheu për rrishikim listat e paraqitura. Edhe në listën e korrigjuar subjekti PD-LN paraqiti numër kandidatësh më shumë se numri i vendosur nga Komisioneri shtetror. Komisioneri shtetror e pranoi, në mënyrë të pjesëshme listën e kandidatëve të subjektit PD-LN, duke rregjistruar vetëm kandidatët e rrjeshtuar në listë, deri në numrin që kishte vendosur dhe deklaruar më parë, për njësinë zgjedhore përkatëse. Vendimi i Komisionerit shtetror, u ankimua në KAS, i cili e vlerësoi atë të pambështetur në ligj. Vendimi i KAS u ankimua në Kolegjin zgjedhor i cili konformoi

vendimin e Komisionerit zgjedhor, duke vendosur efektivisht një kufi të sipërm për listat e kandidatëve.

Para afatit ligjor KQZ-ja regjistroi 12 lista të kandidatëve për deputet, në 12 njësitë zgjedhore, të paraqitura nga subjektet zgjedhore dhe 5 kandidatë të pavarur që garuan në 5 qarqe.

Partitë politike e realizuan procesi për hartimin e listave të kandidatëve, duke e propoganduar si një proces të hapur, me pjesëmarrjen e gjithë antarësisë së partisë. Megjithë këtë, në thelb lista përfundimtare e kandidatëve ishte produkt i vendimmarrjes se lidërshipt të partisë përkatëse.

Pati parti politike që bënë kujdes të shtuar për përfshirjen në listat e kandidatëve të të rinjve. Megjithë atë, kjo sjellje ndaj të rinjve akoma nuk ka arritur të bëhet pjesë e rëndësishme dhe integrale

Tabela nr. 7 Vlerësimi për indikatorin "Rregjistrimi i subjekteve zgjedhore"

Indikator		Vlerësim 1 deri 5
PËRPARA DITËS SE ZGJEDHJEVE	5. Rregjistrimi i subjekteve zgjedhore	
	5.1 Ligj nuk përmban dispozita diskriminuese për rregjistrimin e partive të reja dhe kandidatëve të pavarur	3.5
	5.2 Partitë dhe kandidatët respektuan afatet kohore për rregjistrim si subjekte zgjedhore dhe për regjistrimin e listave të kandidatëve.	5.0
	5.3 Partitë politike respektuan kërkesat e Kodit për numrin e kandidatëve në njësitë zgjedhore.	3.5
	5.4 KQZ-ja dhe Kolegji zgjedhor zbatuan kërkesën e Kodit zgjedhor për numrin e kandidatëve në listën shumëemerore	2.5
	5.5 Lista e kandidatëve nuk janë produkt vetëm i vendimmarrjes së lidërshipt të partisë	2.4
	5.6 Partitë politike janë kujdesur që në listën e kandidatëve të përfaqesohen të rinjët dhe komunitetet e marginalizuar	2.3
	5.7 Pakicat etnike dhe kombëtare kishin mundësi të barabarta për të konkuruar	3.7
	5.8 Qytetarët që banojnë jashtë territorit të vendit kanë mundësi reale për garuar si kandidat për deputet	3.1
	5.9 Qytetarët emigrantë janë të përfaqësuar në listat e kandidatëve të partive politike	1.6
	5.10 Legjislacioni zgjedhor krijon kushte të favorshme për pjesëmarrjen e grave në zgjedhje si kandidate dhe administratore të procesit	4.9
	5.11 Partitë politike respektuan kërkesen për kuota gjinore	4.4
	5.12 Komisioneri shtetror zbatoi kërkesat e ligjit për barazinë gjinore në listat e kandidatëve	5.0
	5.13 Partitë politike e mbajtën parasysh ligjin për dekriminalizimin gjatë procesit të hartimit të listës së kandidatëve	4.3
	5.14 KQZ zbatoi kërkesat e ligjit për pastërtinë e figures se kandidatëve	4.6
	5.15 Qytetarët janë të informuar për procesin e hartimit të listës së kandidatëve nga partitë politike	2.2
	5.16 Përmbajtja e fletës së votimit u dakortësua nga partitë politike	2.4
5.17 Përmbajtja e fletës së votimit nuk e vështirëson votimin me votë parapëlqyese	2.3	
		3.39 (59.75)

e kulturës tek partitë politike. Ndërkohë që përfaqësimin në listat e kandidatëve të komuniteteve të marginalizuar është i pandjeshëm.

Legjislacioni shqiptar parashikon të drejta të plota politike, civile dhe sociale për personat që u përkasin pakicave kombëtare, në përputhje me angazhimet e OSBE-së. Megjithatë legjislacioni nuk ka kufizime diskriminuese për kandidimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare, vetëm disa parti raportuan se kishin kandidatë që u përkisnin këtyre pakicave. Kandidatë nga pakicat rome e egjiptiane, si pakicat me numër më të madh shtetasish, nuk u rregjistruan. Në përgjithësi nuk u vu re asnjë lloj diskriminimi i drejtpërdrejtë ndaj pakicave kombëtare në lidhje me procesin zgjedhor.

Qytetarë që banojnë jashtë territorit të vendit mund të kandidojnë si të pavarur ose të kandidohen nga parti politike. Megjithatë këtë për zgjedhjet e 25 prill 2021, vetëm në ndonjë rast shumë të rralla, nuk pati kandidatë nga komunitetet e shtetasve emigrantë.

Legjislacioni zgjedhor e ka trajtuar në mënyrë efektive problemin e kandidimit të grave e vajzave. Partitë politike dhe KQZ-ja e zbatuan me rrigorrozitet këtë legjislacion.

Kërkesat e ligjit për pastërtinë e figurës, në përgjithësi u plotësuan prej partive politike. KQZ, menjëherë pas regjistrimit të listave të kandidatëve filloi procesin e verifikimit të vetdeklarimeve të kandidatëve. Për disa prej tyre u kërkua verifikim i thelluar.

Duke ju referuar dispozitave të Kodit zgjedhor në të cilat trajtohet vota parapëlqyese dhe kushtet që duhet të plotësojë fleta e votimit në lidhje me këtë votë, problemi i hartimit, i përmbajtjes dhe mënyrës së organizimit të informacionit në fletën e votimit, u bë objekt diskutimi me ngarkesë të madhe politike. Vendimi përfundimtar për fletën e votimit nuk ishte rezultat i dakortësisë midis palëve, mazhorancë e opozitë. Në mungesë të kohës së nevojshme për informimin e zgjedhësve për mënyrën e votimit në fletën e votimit, zgjedhësit patën vështirësi për të administruar votën parapëlqyese. Efekt i kësaj është numri i madh i votave të pavlefshme, rreth 5% të të gjithë votave të hedhura në kuti, në nivel vendi.

Perceptimi për indikatorin “Regjistrimi i subjekteve zgjedhore”, i formuluar si shumim i perceptimeve për faktorët që lidhen me mënyrën se si trajtohet në ligj e drejta për të kandiduar dhe perceptimeve për nivelin e zbatimit të detyrimeve ligjore nga subjektet politike dhe administrata zgjedhore, **vlerësohet në nivelin “i moderuar-i lartë”.** Në këtë mënyrë ky indikator klasifikohet ndër indikatorët me efekt pozitiv të rëndësishëm në indeksin e integritetit të zgjedhjeve që u zhvilluan në 25 prill 2021. I krahasuar me vlerën që ky indikator ka patur në zgjedhjet parlamentare, 2013 dhe 2017 (N. Pippa, et. al., 2019) rezulton të ketë një rritje respektivisht me rreth 28.1% dhe 23.0%.

6. Media dhe fushata zgjedhore

Mjedisi mediatik në Shqipëri është i larmishëm. Në të operojnë një numër i konsiderueshëm operatorësh privat, me mbulim kombëtar dhe lokal. TVSH është media publike e cila mbulon të gjithë territorin e vendit. TVSH operon edhe me njësi lokale në qarqe të ndryshme të vendit. Veç mediave

autovizive dhe të printuara, në mjedisin mediatik shqiptar, për herë e më shumë, po zë terren media sociale dhe portalet.

Monitorimi i zbatimit të kërkesave të paracaktuar në Kodin zgjedhor për median dhe pasqyrimin prej saj të fushatës zgjedhore është detyrë e Komisionerit shtetror. Për kryerjen e kësaj detyre Komisioneri bashkëpunon me AMA. AMA përbëhet nga shtatë anëtarët, që emërohen nga Parlamenti për një mandat 5-vjeçar, me të drejtë rizgjedhje vetëm një herë. Aktualisht, në këtë institucion janë tre vende vakante, ndërkohë që mandati i kryetarit dhe i një anëtari kanë përfunduar. Për të vlerësuar indikatorin që pasqyron rolin e medias në fushatën zgjedhore dhe zbatimin e legjislacionit nga operatorët audioviziv gjatë fushatës zgjedhore u përdorën perceptimet për treguesit e dhënë në Tabelën no. 8. Duke ju referuar vlerave për këta tregues, rezulton se edhe gjatë kësaj fushate zgjedhore roli i mediave dhe shërbimet që ato kanë kryer, në mënyrë të veçantë për operatorët private, në një masë të konsiderueshme janë ndikuar nga interesat e pronarëve të tyre. Partitë politike e përdorën në maksimum hapsirën që ju lejon Kodi zgjedhor për të qënë ato përgatitëset e kronikave për emisionet informative. Jo rrallë, gazetarët nuk u lejuan të ndjekin aktivitetet e subjekteve zgjedhore dhe shpesh ata u përballen me presion dhe u intimiduan. Megjithëse Kodi zgjedhor e trajton në mënyrë të detajuar përdorimin e kohës televizive dhe mënyrën e ushtrimit të të drejtës të subjekteve zgjedhore

Tabela nr. 8 Vlerësimi për indikatorin "Media dhe fushata zgjedhore"

Indikator		Vlerësim 1 deri 5	
FUSHA ZGJEDHORE	6. Media dhe fushata zgjedhore		
	6.1 Radio dhe Televizioni Publik zbatoi kërkesat e Kodit zgjedhor në lidhje me kohën e transmetimit të aktiviteteve të subjekteve zgjedhore	3.9	3.26 (56.50)
	6.2 Radio dhe Televizioni Publik mbuloi fushatën elektorale përmes lajmeve ose programeve informuese në përputhje me parimet e përcaktuara në Kodin zgjedhor	3.7	
	6.3 Privat radiot dhe televizionet mbuluan fushatën zgjedhore vetëm gjatë edicionit të lajmeve dhe rubrikave speciale.	3.5	
	6.4 Partitë politike kishin akses në media audiovizive në përputhje me standardet dhe Kodin zgjedhor	3.2	
	6.5 Mediat pasqyruan në mënyrë reale mesazhet e subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve	3.6	
	6.5 Gazetarët e lajmeve u lejuan të ndiqnin dhe lirisht aktivitetet e fushatës zgjedhore	2.6	
	6.6 Gazetarët e lajmeve mbuluan fushatën zgjedhore pa presion	2.9	
	6.7 KQZ dhe AMA e monitoruan media në përputhje me kërkesat e Kodit zgjedhor, në mënyrë transparente dhe panashmëri	4.3	
	6.8 Media audiovizive shmangu fushatën dhe mesazhet negative	3.2	
	6.9 Media private i respektoi kërkesat e Kodit Zgjedhor për transmetimin e reklamave elektorale të partive politike	3.4	
6.10 Mediat lokale kishin akses të njëjtë me mediat kombëtare në pasqyrimin e fushatës elektorale	3.1		

6.11 Kandidatët e partive politike ose të pavaruar kishin akses të mjaftueshëm në media për t`u prezantuar me zgjedhësit dhe shpalosur idetë dhe programin e tyre.	2.6
6.12 Mediat sociale nuk ndikuan tek votuesit	3.1
6.13 Media sociale nuk u keq përdor	3.6
6.14 Debatet elektorale u përdorën për të paraqitur programet qeverisëse	2.2
6.15 Informimi i publikut kandidatët/partitë ishte i mjaftueshëm, objektiv dhe i balancuar	3.1

për të blere kohe televizive për reklama politike, rezultatet e monitorimit të AMA të paraqitura çdo ditë dhe të përmbledhura, tregojnë se këto kërkesa të ligjit shpesh nuk u zbatuan nga operatorët mediatik dhe subjektet zgjedhore. Në veçanti me e shpeshtë ishte kjo dukuri në mediat audiovizive lokale.

Në përgjithësi, Komisioneri shtetror zbatoi kërkesat e ligjit për ndarjen e kohës televizive dhe, mbështetur në raportimet e AMA, vendosi për masat penalizuese për shkelësit e parashikimeve ligjore.

AMA monitoroi rreth 30 operatorë autoviziv. Duke i kushtuar vëmendje matjes së kohës televizive, rendit të shfaqjes së subjekteve politike në edicionet informative, raportit gjinor, cilësisë së performancë në lidhje me përmbushjen e kërkesave profesionale dhe ligjore, të përcaktuara në ligjin për mediat, AMA, në përgjithësi, e përmbushi detyrën në përputhje me kërkesat e ligjit.

Mungesa e organizimit dhe zhvillimit të forumeve me kandidatët dhe subjektet zgjedhore në mediat elektronike me mbulim kombëtar e lokal, vlerësohet si një standard i paarritur në fushatën zgjedhore.

Komisioneri shtetror nuk arriti të organizonte dhe të zhvillonte monitorimin e medias së printuar. Jashtë vëmendjes së tij ishte edhe monitorimi i protaleve ose organizimi i punës për grumbullimin e informacionit që mund të përdorej për vlerësimin e rolit të medias sociale në fushatën zgjedhore. Megjithë këtë, perceptimet e grumbulluara për rolin e medias sociale, për ndikimin e saj tek zgjedhësi dhe për masen e përdorimit i saj prej subjekteve zgjedhore dhe kandidateve, e vlerësojnë pozitën dhe rolin e kesaj medie në fushatën zgjedhore, në nivelin "I moderuar".

Shumimi i perceptimeve për indikatorin "Media dhe fushat zgjedhore", e rendit këtë indikator në grupin e indikatorëve që i përkasi nivelit "i moderuar". Duke u krahasuar vlerën e tij (56.5 pikë) me vlerat që ka publikuar për të N. Pippa, et. al., (2019) për zgjedhjet parlamentare të zhvilluara në 2013 (47.0 pikë) dhe 2017 (48.0 pikë) mund të pohohet se, sjellja dhe përdorimi i media audiovizive gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet parlamentare 25 prill 2021, shënoi progres pozitiv në respektimin e ligjit dhe plotësimin e standardeve

7. Financimi dhe fushata zgjedhore

Për të vlerësuar indikatorin mbi financimin dhe fushatën zgjedhore u përdorën vlerat e perceptimeve për 17 tregues (Tabela no. 9). **Vlera mesatare e këtij indikator rezultoi 2.65 (vlera e**

standartizuar 41.25 pikë). **Financimi dhe fushata zgjedhore vlerësohet në nivelin "I ulët"**. Pippa, N. et al (2019) për zgjedhjet parlamentare të zhvilluara në vitin 2013 dhe 2017, e vlerësojnë këtë indikator në të njëjtin nivel.

Tabela nr. 9 Vlerësimi për indikatorin "Financimi dhe fushata zgjedhore"

Indikator		Vlerësim 1 deri 5	
FUSHA ZGJEDHORE	9. Financimi dhe fushata zgjedhore		
	9.1 Rregullat për financimin e fushatës janë të qarta dhe të plota	3.6	2.61 (40.25)
	9.2 Kërkesat e Kodit zgjedhor për financimet me fonde private u zbatuan nga subjektet politike dhe kandidatët	2.8	
	9.3 Partitë / kandidatët kishin qasje propocionale në fondet publike	4.0	
	9.4 Partitë / kandidatët kishin qasje propocionale në fondet private	2.8	
	9.5 Partitë / kandidatët i bënë transparente burimet e financimit në përputhje me kërkesat e Kodit zgjedhor.	3.0	
	9.6 Partitë respektojnë Kodin zgjedhor për përdorimin e aseteve publike	1.5	
	9.7 Partia në pushtet nuk largoi ose nuk punësoi punonjës për qëllime elektorale	1.3	
	9.8 Monitorimi nga KQZ-ja, në kohë reale, i shpenzimeve të partive për fushatën zgjedhore ishte efektiv dhe e rriti transparencën e këtyre shpenzimeve	2.0	
	9.9 Denoncimi i shkeljeve në përdorimin e aseteve publike uli shpeshtësinë e këtij fenomeni	2.1	
	9.10 Ndryshimet në Kodin zgjedhor dhe Kodin penal ndikuan në zvogëlimin e fenomenit të shitblerjes së votës	2.2	
	9.11 Prokuroria dhe SPAK reagon në mënyrë efektive ndaj denoncimeve për shitblerjen e votës dhe/ose shkeljeve të ligjit zgjedhor	2.4	
	9.12 Partitë politike dhe kandidatët i bënë transparente burimet e financimit me fonde private	2.2	
	9.13 Partitë politike e mbështetën fushatën në paraqitjen e programeve të tyre qeverisëse	3.8	
	9.14 Partitë politike nuk zhvilluan fushatë negative	2.9	
	9.15 Partitë politike nuk përdoren instrumenta dhe metodat për intimidimin e zgjedhësve	2.5	
	9.16 Partitë politike nuk ndikuan në rritjen e tensionit politik gjatë fushatës zgjedhore	2.5	
9.17 Institucionet ligjzbatuese ndikuan në zhvillimin e një fushate zgjedhore pa probleme të rendit dhe për parandalimin e intimidimit të zgjedhësve	2.7		

Duke ju referuar treguesve që janë marr në konsideratë për vlerësimin e këtij indikator, mund të dallohen dy grupe:

- (i) treguesit që lidhen me financimin e fushatës zgjedhore dhe
- (ii) treguesit që pasqyrojnë zhvillimin e fushatës.

Financimi i fushatës zgjedhore është një dukuri komplekse. Për vlerësimin e tij duhet të merren në konsideratë burimet e ndryshme të financimit dhe bashkë me to edhe përdorimi i aseteve publike dhe i mundësive që ka pushtetit për të ndikuar te zgjedhësi me mekanizma të ndryshme ekonomike. Financimi i fushatës zgjedhore është një ndër faktorët me efekt të madh në cilësinë e procesit

zgjedhor dhe në plotësimin e standardeve për barazinë në garën zgjedhore. Vlera mesatare e treguesve përbërës të financimit të fushatës zgjedhore rezultoi 2.49 (37.25 pikë), duke e klasifikuar atë në nivelin "Shumë i ulët". Ndërkohë, vlera mesatare e treguesve që pasqyrojnë fushatën zgjedhore rezultoi 2.88 (47.00 pikë) duke e klasifikuar fushatën zgjedhore në nivelin "I ulët". Si shihet, analiza sasiore e perceptimeve për financimin dhe për fushatën zgjedhore, i identifikon këto të dy si indikator problematik për procesin zgjedhor të 25 prill 2021.

Duke ju referuar vlerësimeve për treguesit e ndryshëm, veprimi dhe bashkeveprimi i të cilëve kanë si efekt të tyre vlerën e indikatorin "Financim dhe fushata zgjedhore", ndër treguesit që kanë efekte më të mëdha negative, mund të renditen:

- Vullneti i munguar i partive politike për të zbatuar kërkesat e Kodit zgjedhor në lidhje me financimin e fushatës së tyre zgjedhore me fonde private, në veçanti mungesa e transparencës për burimin e këtyre financimeve dhe përdorimin tyre për blerjen e votës.

- Mundësitë jo propocionale midis partive politike për të siguruar fonde nga burime private.

- Përdorimi për qëllime të fushatës zgjedhore të aseteve publike, fondeve financiare publike dhe aktiviteteve publike. PS, duke i anashkaluar kushtëzimet ligjore, gërmën ose frymën e tyre, i përdori të gjitha mundësitë që i jepte të qenit parti qeverisëse, në nivel qendror dhe lokal. Në shumë raste aktiviteteve publike të zhvilluara nga institucionet publike ishin dukshme aktivitete që i shërbenin fushatës së PS. Punonjës të administratës publike u aktivizuan në fushatën zgjedhore që zhvilluan drejtuesit e tyre. Në jo pak raste drejtues të ministrive kandidatë të PS, bashkë me stafin e afërt të tyre, qëndruan gjatë të gjithë kohës së fushatës zgjedhore në njësitë zgjedhore ku kandidonin.

- KQZ nuk arriti të realizonte pritshmëritë që lidhen me përfshirjen në Kodin zgjedhor të dispozitave që i jepin të drejtën dhe detyren për monitorimin, në kohe reale të shpenzimeve të partive politike gjatë dhe për fushatën zgjedhore.

- Institucionet ligjzbatuese, policia e shtetit, prokuroria dhe SPAK nuk arritën të ndikojnë në mënyrë efektive në parandalimin e shkeljeve të ligjit zgjedhor.

Reagimi i vonuar i institucioneve por edhe pamjaftueshmëria e përfshirjes së shoqërisë në luftën kundër fenomenit të shitblerjes së votës, nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, angazhimi intensiv dhe i strukturuar, me përfshirjen në të edhe të individëve dhe subjekteve private me fuqi ekonomike, në shitblerje, ndikuan në perceptimin e publikut për shpeshtësinë e lartë të këtij fenomeni, me pasojë rënien e besimit tek procesi zgjedhor. Gjatë fushatës zgjedhore pati deklarime nga përfaqësues të forcave politike dhe denoncime për fenomenin e shitblerjes së votës dhe intimidimit të zgjedhëseve. Denoncimet e bera në SPAK vunë në levizje këtë institucion, i cili njoftoi publikun për çështjet e denoncuar dhe për vendimet e tij në lidhje me shqyrtimin e metejshme të tyre. Megjithë këtë, ngadalesia në reagim, e prokurorisë dhe e SPAK, e justifikuar me detyrimet proceduariale, nuk i shërbeu parandalimit të shkeljeve të ligjit zgjedhor, duke mos arritur të realizoi pritshmëritë e parashikuara nga ndryshimet e bera në legjislacion për rolin dhe sjelljen e këtyre institucioneve në proceset zgjedhore.

Partitë politike zhvilluan një fushatë zgjedhore jotipikë. Nuk i kushtuan vendin e duhur paraqitjes së programeve qeverisëse të tyre. U fokusuan në përcjelljen e mesazheve që ishin të lidhur kryesisht me efektet e tërmetit dhe pandemisë, duke ndikuar vetëm emocionalisht tek zgjedhës. Tonet negative të fushatës e ulën interesin tek zgjedhësit dhe ndikuan në perceptimin jo të mirë të tyre për fushatën.

Partitë politike jo vetëm që nuk kontribuan por, në të kundërtën, ndikuan për nxitjen dhe rritjen e tensionit politik gjatë fushatës. Kërkimi dhe përdorimi i mundësive dhe instrumentave për të bërë presion tek zgjedhësit ishte fenomen që bashkeshoqëroi fushatën zgjedhore.

Mbështetur në vëzhgimet dhe perceptimet për fushatën zgjedhore, financimin e saj dhe sjelljen e partive politike e kandidatëve gjatë kesaj fushate, në linjat kryesore mund të pohohet se:

Fushata u zhvillua në kushtet e kufizimeve të vendosura si pasojë e pandemisë së shkaktuar nga COVID-19, të cilat përfshinë edhe kufizimet e tubimeve dhe ruajtjen e distancimit social, kufizime të cilat nuk u respektuan në të gjitha rastet dhe nga të gjithë partitë politike, në vecanti PD. Në fillimet e saj, fushata u karakterizua nga një ton jo i moderuar i përdorur prej udhëheqësve kryesorë të partive politike. Akuzat e ngritura për korrupsion dhe për lidhje me krimin e organizuar zëvendësuan informimin e zgjedhësve për programet qeverisëse të partive politike. PS e përqëndroi mesazhin e saj në përpjekjet e sukseshme dhe aftësitë e saj për të përballuar situatën e pandemisë, duke theksuar se vetëm ajo kishte kapacitetet e duhura. Opozita përcolli mesazhin e kundërt. Përqëndrimi i madh i të dy paleve në këtë çështje e denaturoi fushatën zgjedhore. **Për pasojë, perceptimi për fushatën zgjedhore e klasifikon atë në grupin e indikatorve që vlerësohen në nivelin "I ultë"**

Presidenti i Republikës i bëri thirrje të vazhdueshme qytetarëve, subjekteve politike, administratës zgjedhore dhe institucioneve ligjzbatuese për angazhim në zhvillimin e zgjedhjeve të lira e demokratike dhe për zbatimin e ligji. Prezenca e tij në fushatën elektorale u vlerësua nga PS si kapërxim i të drejtave të këtij institucioni. Presidenti u akuzua se ishte palë me partitë e opozitës. Kjo nuk i shërbeu klimes politike në të cilën u zhvillua fushata elektorale. Për pasojë dhe perceptimi për këtë fazë të rëndësishme të procesit zgjedhor nuk e mbështet pohimin për zhvillim e saj në përputhje dhe zbatim të standardeve për zgjedhje demokratike.

8. Dita e votimit

Mbështetur në vëzhgimet dhe perceptimin për ditën e votim, për të gjitha fazat e saj, hapjen e qendrave të votimit, procesin e votimit, mbylljen e tij dhe administrimin e materialeve zgjedhore deri në dërgimin e tyre në vendet e numrimit të votave, mund të pohohet se, në këtë fazë procesi zgjedhor, në përgjithësi u zhvillua në përputhje me kërkesat e legjislacion dhe në plotësim të kërkesave për zgjedhje demokratike. **Indikatori që shërben për të vlerësuar nivelin e integritetit të procesit zgjedhor në këtë fazë të tij vlerësohet me 4.11 (77.75 pikë), në nivelin "Shumë i lartë"**. E krahasuar vlera e këtij indikatori me vlerat e komunikuara nga Pippa, N. et al, 2019, për zgjedhjet parlamentare 2013 e 2017, respektivisht 46 pikë dhe 45 pikë, mund të pohohet se, në këtë fazë të procesit zgjedhor është bërë progres i ndjeshëm në plotësimin e standardeve.

Komisionet e qendrave të votimit, zbatuan kërkesat e Kodit zgjedhor dhe udhëzimet e KQZ për

hapjen e qendrës së votimit. Në çdo qendër votimi ishin të afishuara materialeve ku tregohet procedura e votimi dhe listat e kandidatëve të subjekteve zgjedhore. Qendrat e votimit ishin të vendosura në ambiente të përshtatëshme. U vëzhguan raste kur komisioni i qendrës së votimit nuk kishte marr masa për të lehtësuar aksesin në lëvizje të votueseve me aftësi të kufizuara.

Proçesi i votimit, gjatë gjithë ditës dhe pothuajse në të gjithë qendrat e votimit të vëzhguara prej vëzhguesve të Rrjetit të Vëzhgueseve të Pavarur, u zhvilluar i qetë, pa probleme të rendit dhe pa ndërprerje që mund të shkaktoheshin nga ndërhyrje të personave të paautorizuar. Ndërprerje të shkurtra të proçesit të votimit, si pasojë e mosfunksionimit të pajisjes për identifikimin biometrik të zgjedhësve, u raportuan në rreth 10 përqind të qendrave të votimit të vëzhguara.

Tabela nr. 10 Vlerësimi për indikatorin "Dita e votimit"

Indikator		Vlerësim 1 deri 5	
DITA E ZGJEDHJEVE	10. Proçesi i votimit		
	10.1 Komisioni i QV zbatoi kërkesat e Kodit zgjedhore për hapjen e qendrës së votimit	4.8	4.11 (77.75)
	10.2 Materialet për informimin e zgjedhësve për proçedurat e votimit dhe votimin parapëlqyes ishin afishuar në përputhje me Kodin zgjedhor dhe udhëzimet e KAZ-së	4.8	
	10.3 Qënda e votimit ishe e përshtatur për të mundësuar votimin për personat me aftësi të kufizuara	3.5	
	10.4 Proçesi i votimit u zhvillua i qetë dhe pa probleme të rendit	3.7	
	10.5 Persona të paautorizuar nuk ndërhyjnë në proçesin e votimit në qendrën e votimit	3.8	
	10.6 Policia e rendit zbatoi kërkesat e Kodit zgjedhor	4.4	
	10.7 Komisioni i qendres së votimi zbatoi proçedurat ligjore për identifikimin biometrik të zgjedhësve	4.2	
	10.8 Komisioni i qendres së votimi zbatoi proçedurat ligjore për votimin e fshehtë dhe moslejimin e votimit familjarë	3.9	
	10.9 Komisioni i qendres së votimi zbatoi proçedurat ligjore për votimin me prokurë për votuesit me aftësi të kufizuara	2.8	
	10.10 Ndaj votueseve nuk u ushtrua presion për të votuar një subjekt/kandidat të caktuar	3.7	
	10.11 Votuesit i njihnin proçedurat e votimit	3.3	
	10.12 Votuesit e dinin se si duhet të votohej me votën parapëlqyese	2.9	
	10.13 Votuesit me vendim gjyqi për votuar, u lejuan të votonin	5.0	
	10.14 Qendra e votimit u mbyll në përputhje me ligjin	4.7	
	10.15 Në qendrën e votimit qendruan vetëm personat e autorizuar	4.6	
	10.16 Materialet zgjedhore u administruan në përputhje me kërkesat e Kodit zgjedhor	4.9	
10.17 Kutitë me materialet zgjedhore dhe fletët e votimit u nisen për VN në përputhje me proçedurat e përcaktuara	4.9		

Forcat e rendit, në përgjithësi zbatuan kërkesat e Kodit zgjedhor dhe udhëzimin e Komisionit rregullator për prezencën e tyre në afërsi të qendrës së votimit. Nuk pati raste të ndërhyrjes së policisë së rendit për vendosjen e rendit në qendrën e votimit.

Në përgjithësi, anëtarët e komisioneve në qendrat e votimit e zbatuan me korrektesë Kodin zgjedhor dhe udhëzimin për procedurat që duhet të ndiqte çdo votues për të votuar. Zgjedhësit nuk u lejuan të votonin përpara se të kryhej identifikimi biometrik i tyre, të merreshin shenjat daktiloskopikë dhe t`ju vendosej shënja me bojë në gisht. Votim u krye në dhomën e fshehtë. Në përgjithësi, komisionet e qendrave të votimit respektuan rregullin për votimin me prokurë për zgjedhësit me aftësi të kufizuara. Në qendrat ku ishin vendosur kamera për rregjistrimin e punës së komisionit, nuk u raportuan raste të mos funksionimit të tyre.

Zgjedhësit u deklaruan se i njihnin mjaftueshëm rregullat për votim por, u shprehen, në jo pak raste, se kishit pasiguri në mënyrën se si do të votonin me votë parapëlqyese

Mbyllja e procesit të votimit, në përgjithësi ishte e qetë dhe në përputhje me kërkesat e ligjit. Pas deklarimit të mbylljes së procesit të votimit, komisionet e qendrave të votimit zbatuan procedurat e administrimit të materialeve zgjedhore, sipas ligjit. Organizimi i transportit të kutive të votimit u krye në përputhje me procedurën e parashikuar.

9. Vlerësimi, numërimi i votave dhe tabelimi i rezultateve

Vlerësimi për zhvillimin e kësaj faze të procesit zgjedhor është mbështetur në informacione të marr nga vëzhguesit e Rrjetit të Vëzhguesve të Pavarur si dhe informacioni i grumbulluar nga specialistët e angazhuar prej INSIZ, për vlerësimin e perceptimeve, me qëllim vlerësimin e Indeksit të integritetit të zgjedhjeve.

- Marrja në dorëzim e kutive me materialet zgjedhore dhe fletë e votimit prej KZAZ-ve u zhvillua në përputhje me procedurat e parashikuara ligjore. Dorëzimi i tyre u zhvillua i qetë, pa probleme dhe transparent.

- Administrimi i materialeve zgjedhore, vlerësimi dhe numërimi i votave, në përgjithësi u krye në përputhje me procedurat e parashikuar dhe pa probleme me efekte të ndjeshme në ecurinë e tij.

- Vëzhguesit patën akses me procesin e numërimit të votave si parashikohet në Kodin zgjedhor dhe udhëzimin e KQZ-se

- Tabelimi i rezultateve për subjektet zgjedhore u krye brënda kohës së përcaktuar në udhëzimin e KQZ-së.

- Nuk pati kundërshtime dhe mos pranim të tabelës së rezultateve nga komisionerët ose nga vëzhguesit e subjekteve zgjedhore.

- Policia e shtetit zbatoi kërkesat e ligjit gjatë procesit të numërimit të votave.

- Ndërhyrja e përfaqesuesve të subjekteve të ndryshme zgjedhore në procesin e numërimit të votave vetëm në disa raste të pakta krijoi probleme, ndërprerje të procesit ose prishje të rendit në VNV. Prezenca e kandidatëve dhe e përfaqesuesve të subjekteve zgjedhore, e cila parashikohet nga Kodi Zgjedhor me qëllim që të krijohen kushte për sa më shumë transparencë në procesin e numërimit të votave, në disa raste ndikoi negativisht në rrjedhjen normale të këtij procesi.

- Informimi i publikut *on-line*, në kohë reale, për rezultatet e numërimit të votave në çdo qëndër votimi, nëpërmjet teknikës mbështetëse të instaluar në mjediset e KQZ-se, ndikoi për rritjen e

Tabela nr. 11 Vlerësimi për indikatorin “Vlerësimi, numrimi i votave”

	Indikator	Vlerësim 1 deri 5	
PAS DITËS SË ZGJEDHJEVE	11. Vlerësimi dhe numërimi i votive		
	11.1 KZAZ zbatoi kërkesat e ligjit për marrjen në dorezim të kutive me materialet e votimit dhe fletët e votimit	4.7	4.07 (76.75)
	11.2 Dorezimi i materialeve dhe kutive të votimit u zhvillua i qetë dhe pa probleme	4.1	
	11.3 Vëzhguesit kishin mundësi të vëzhgonin procesin e marrjes në dorezim të kutive me materiale dhe fletët e votimit	3.5	
	11.4 Grupi i numërimit të votave zbatoi kërkesat e ligjit për vlerësimin dhe numërimin e votave	3.9	
	11.5 Vëzhguesit patën akses me procesin e numërimit të votave si parashikohet në Kodin zgjedhor dhe udhëzimin e KQZ-se	3.4	
	11.6 KZAZ zbatoi kërkesat e ligjit për vlerësimin dhe numërimin e votave	4.3	
	11.7 Proçesi i numërimit dhe vlerësimit të votave nga NGV u krye në përputhje me proceduar e parashikuara	4.7	
	11.8 Proçesi i numërimit dhe vlerësimit të votave për subjektet dhe votat parapëlqyese për kandidatët u zhvillua normalisht dhe pa incidente	3.8	
	11.9 Vëzhguesit e subjekteve elektorale dhe kandidateve kishin mundësi të monitoronin dhe vëzhgonin, sipas ligjit vlerësimin dhe numërimin e votave	3.5	
	11.10 Tabelimi të rezultateve u krye në përputhje me ligjin	4.0	
	11.11 KZAZ transmetoi, në kohe reale dhe sipas udhëzimit të KQZ, tabelat e rezultateve në KQZ.	4.3	
	11.12 Media ishte e pranishme gjatë të gjithë proçesit të vlerësimit dhe numërimit të votave	4.6	

transparencës në këtë faze të proçesit.

- Proçesi i numërimit të votave dhe tabelimit të rezultateve për subjektet zgjedhore u përfundua në të gjithë KZAZ, duke arritur që, vetëm me përjashtime shumë të vogla, ato të formulojnë dhe miratojnë vendimet përkatëse me shumicë të cilësuar të votave.

- Numri i votave të pavlefshme rezultoi relativisht i madh, rreth 5% e të gjithë votave, në rang vendi. Ky fakt gjeneroi kundërshtitë dhe deklarimet e forcave politike dhe kandidatëve për keq administrimin e votave në proçesin e vlerësimit dhe numërimit të tyre, për të cilin ato deklaruan se do të paraqesin kërkesa ankimore në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve

Indikatorin “Vlerësimi, numërimi i votave dhe tabelimi i rezultateve” vlerësohet me 4.07 (76.75 pikë) në nivelin “Shumë i lartë”.

Pippa, N. et al. (2019) për këtë indikator komunikojnë vlerat mesatare 76 pikë dhe 67 pikë, respektivisht për zgjedhjet parlamentare të zhvilluara në 2013 dhe 2017.

Vlerësimi për këtë indikator për zgjedhjet e 25 prill 2021, tregon se, në këtë fazë të proçesit zgjedhor tashmë është krijuar një përvojë pozitive. Problemet me të cilat është ndeshur administrimi i materialeve dhe fletëve të votimit nga grupet e numërimit të votave dhe KZAZ-të, gjatë vlerësimit, numërimit dhe tabelimit të rezultateve, nuk kanë arritur të sjellin efekte të ndjeshme, të cilat të

shkaktonin shkelje të ligjit dhe të procedurave, me ndikim në cilësinë dhe integritetin e gjithë procesit zgjedhor.

10. Ankime për rezultatin

Për vlerësimin e indikatorit që pasqyron procesin e administrimit të ankimeve nga KAS dhe gjykimin e padive të bëra ndaj vendimeve të KAS, në Kolegjin gjyqesor u përdorën treguesit e paraqitur në Table no.12.

Vlera mesatare për këtë indikator rezulton 3.17 (54.25 pikë). Indikatorit klasifikohet në nivelin "I moderuar".

Tabela nr. 12 Vlerësimi për indikatorin "Ankimet dhe gjykimet"

	Indikator	Vlerësim 1 deri 5	
PAS DITËS SË ZGJEDHJEVE	12. Ankime/gjykime parazgjedhore		
	12.1 Akimet parazgjedhore u bënë në përputhje me Kodin zgjedhor.	4.2	3.17 (54.25)
	12.2 KAS i administroi ankimet parazgjedhore në përputhje me kërkesat e Kodit zgjedhor.	3.1	
	12.3 Kolegji gjyqesor i gjykoi paditë për vendimet e KAS për ankimet parazgjedhore, në mënyrë objektive.	3.3	
	13. Ankime/gjykime për rezultatin		
	13.1 Partitë e pranuan rezultatin	2.2	
	13.2 Kandidatët e pranuan rezultatin	3.3	
	13.3 Procedurat e ankimeve për rezultatin u bënë në përputhje me kërkesat e Kodit zgjedhor	4.5	
	13.4 KAS i shqyrtoi ankimet për rezultatin në përputhje me ligjin	2.6	
	13.5 Kolegji gjyqesor i shqyrtoi paditë për vendimet e KAS ankimet për rezultatin në mënyrë objektive	3.0	
	13.6 Rezultati i zgjedhjeve nuk shkaktoi incidente të rënda, prishje të rendit dhe protesta të dhunshme	4.2	
	13.7 Sanksionet për shkeljet e Kodit zgjedhor u zbatuan në përputhje me ligjin dhe patën efekte positive në pranimin e rezultatit të zgjedhjeve	2.5	
	13.8 Në vendimmarrjen e KAS nuk kishte efekt zgjedhja e antareve të tij në bazë të përzgjedhjes politike	2.0	

I krahasur ky nivel me atë të publikuar nga Pippa, N. et. al (2019) për zgjedhjet parlamentare 2013 (78 pikë) dhe zgjedhjet parlamentare 2017 (71 pikë), rezulton se, në bazë të perceptimit, për këtë fazë të rëndësishme të procesit zgjedhor, në zgjedhjet e 25 prill 2021 nuk është bërë progress.

Administrimi i ankimeve nga KAS dhe gjykimi i padive nga Kolegjit gjyqesor zgjedhor u zhvilluan si procese që u kundërshtuan nga subjektet ankimese. Ankimesit u deklaruan se vendimmarrja e KAS dhe Kolegjit gjyqesor ishte e ndikuar nga partia e mazhoranca, PS.

Duke ju referuar treguesve që janë marr në konsideratë për vlerësimin e këtij indikator, duhet të theksohet se midis tyre ka tregues të rëndësishëm për të cilët perceptimet nuk janë entuziaste. Kështu p.sh. pranimi i rezultatit nga partitë politike dhe subjekte të caktuara zgjedhore vlerësohet në nivel të ulët 2.2 (30.0 pikë); vendimmarrja e KAS perceptohet se ishte e ndikuar nga interesat e partive

politike që kanë mbështetur kandidaturat e antarëve të këtij komisioni, 2.6 (40.25 pikë) niveli "shumë i ulët"; vendimet për sanksionet nuk arritën të gjeneronin efektin e pritshëm, perceptimi për këto vendime është i ulët, 2.5 (37.5 pikë).

Këta tregues, në se i referohemi efektit të tyre në integritetin e procesit të ankimeve dhe të zgjedhjeve në tërësi, janë dukshëm të rëndësishëm. Ndërkohë, në se i referohemi metodologjisë së përdorur për vlerësimin e indikatorëve, sipas kësaj metodologjie, në aspektin llogaritës të gjithë këta tregues konsiderohen të barazvlefshëm, megjithëse, në fakt, efekti i tyre në integritetin e procesit është ndjeshëm i ndryshëm. Për pasojë dhe interpretimi i vlerës mesatare të këtij indikatorit duhet të bëhet në mënyrë të kujdesshme.

11. Autoritete zgjedhore

Roli i autoriteteve zgjedhore, KQZ, KZAZ, KQV dhe GNV në përgatitjen dhe administrimin e

Tabela nr. 13 Vlerësimi për indikatorin "Autoritete zgjedhore"

	Indikator	Vlerësim 1 deri 5	
PAS DITËS SË ZGJEDHJEVE	14. Autoritetet zgjedhore		
	14.1 KQZ e riformuar ka marr vendime sipas linjave partiake.	3.6	3.43 (60.75)
	14.2 Puna e KQZ ishte transparente	5.0	
	14.3 Komisionet zgjedhore kanë qënë të pavarura nga preferenca partiake në vendimmarrjen e tyre.	3.4	
	14.4 KZAZ kanë qënë transparente në vendimmarrje.	4.8	
	14.5 Vendimet në komisionet zgjedhore kanë qënë konsensuale.	3.6	
	14.6 KQZ zhvilloi një proces intensiv trajnimi për komisionerët.	3.1	
	14.7 KQZ zbatoi sipas kërkesave të ligjit detyrimin për monitorimin, në kohë reale, të shpenzimeve për fushatën zgjedhore.	2.8	
	14.8 KQZ zbatoi sipas kërkesave të ligjit detyrimin për parandalimin e përdorimit të aseteve publike për fushatë zgjedhore.	2.5	
	14.9 KQZ ka bërë fushatë efektive për informimin dhe edukimin e zgjedhësve	4.5	
	14.10 Zgjedhësit janë informuar dhe keshilluar për votimin me votë parapëlqyese	2.9	
	14.11 Votuesit për herë të parë janë të informuar dhe ndërgjegjësuar për procedurën e regjistrimit në listën e zgjedhësve dhe për votim.	3.1	
	14.12 Zgjedhësit emigrantë janë informuar për ndryshimet e bera në Kodin zgjedhor.	2.0	
	14.13 KQZ informoi, sensibilizoi dhe edukoi zgjedhësit e pakicave kombëtare në gjuhën e tyre amtare.	2.0	
	14.14 KQZ u angazhua për votimin e emigrantëve.	1.0	
	14.15 KQZ u angazhua plotësisht për përdorimin e teknologjisë së informacionit.	5.0	
	14.16 Komisionet kanë qënë bashkëpunues me median.	4.2	
	14.17 Partitë politike nuk ushtruan presion mbi komisionerët.	3.1	
	14.18 Komisionet zgjedhore e administruan mirë procesin zgjedhor	4.5	
11.19 Midis komisionerëve dhe autoriteteve vendore kishte bashkëpunim dhe koordinim efektiv	4.0		

proçesit zgjedhor është shumë i rëndësishme. Integriteti i të gjithë proçesit, niveli i respektimit dhe plotësimin të standardeve në zgjedhje, në një masë të konsiderueshme, varet nga puna që bëjnë këto autoritete në zbatim të ligjit.

Për të gjykuar dhe për të vlerësuar efektin e punës së autoriteteve zgjedhore në integritetin e zgjedhjeve, u përdorën perceptimet për treguesit e paraqitur në Tab. No. 13. Përzgjedhja e këtyre treguesve u bë duke patur parasysh faktorët që *a priori* mund të pranohet se ndikojnë në punën e autoriteteve zgjedhore dhe veçoritë dalluese e karakteristikat kryesore të sjelljes së administratës, në përgjithësi dhe administratës zgjedhore, në veçanti, në vendin tonë, të shfaqura në zgjedhjet e mëparëshme. Ndër këto u bë kujdes që të përfshihen faktorë që shërbejnë për të identifikuar dhe vlerësuar efektin e partive politike në punën e autoriteteve zgjedhore, transparencën e tyre në vendim-marrje, profesionalizmin, nivelin e zbatimit të detyrimeve ligjore për informimin, edukimin e zgjedhësve, bashkëpunimin ndër institucional etj..

Vlera e indikatorit “Autoritete zgjedhore” rezuloi 3.43 (60.75 pikë). Ky indikator klasifikohet në nivelin “I lartë” por duke u pozicionuar në fashën e ulët të këtij niveli. Megjithëse ky indikator ka kapërxyer kufirin që ndan nivelin “I moderuar“ nga niveli “I lartë”, rritja në vlerë e tij, në krahasim me vlerën që komunikon për të Pippa, N. et al. (2019) për zgjedhjet parlamentare 2013 (56 pikë) dhe zgjedhjet parlamentare 2017 (57 pikë), është vetëm rreth 6.5-8.4 pikë për qindje më e madhe.


Perceptimi për efektiv jo pozitiv që ka zgjedhja e antarëve të komisioneve zgjedhore mbi bazën e propozimeve të partive politike, vazhdon të jetë zotruar. Vendimmarja konsensuale akoma nuk ka arritur të jetë mbizotruese në komisionet e të gjithë nivele, ndërkohë që niveli i transparencës në këtë vendimmarje perceptohet maksimalisht.

KQZ nuk arriti të realizoi cilësisht proçesin e trajnimit të komisionerëve dhe të teknikëve që përdoren teknologjinë e informacionit. Ky institucion dështoi në plotësimin e detyrimeve ligjore që lidhen me parandalimin e përdorimit për qëllime të fushatës zgjedhore të aseteve dhe veprimtarive publike dhe në monitorimin, në kohë reale, të shpenzimeve për fushatën zgjedhore.

Komisioni nuk arriti të zhvillonte një fushatë efektive informimin për votimin me votë parapëlqyese, nuk informoi, nuk sensibilizoi dhe nuk arriti të realizoi, në mënyrë të plotë dhe si e kërkon ligji, edukimin zgjedhësve të pakicave kombëtare, në gjuhën e tyre amtare. Dështim është edhe puna që duhet të bënte KQZ-ja për votimin e shtetasve nga jashtë territorit të vendit. Ndërkohë, perceptimet për punën dhe angazhimin e KQZ-se për përdorimin e teknologjise se informacionit në zgjedhje janë entuziaste. Të tilla janë perceptimet edhe për bashkëpunimin e autoriteteve zgjedhore me median dhe autoritetet vendore. Në përgjithësi puna e autoriteteve zgjedhore për administrimin e proçesit zgjedhore, perceptohet si një arritje që duhet të përshëndetet. Vlerësimi për të është 4.5 pikë (87.5 pikë), niveli “shumë i lartë

V. Indeksi i integritetit të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë – 25 prill 2021

Në Metodologjinë hartuar nga Pippa, N. et, al (2014) për vlerësimin e perceptimeve për indeksin e integritetit të zgjedhjeve (PEI), vlera e këtij indeksi llogaritet si mesatare e vlerave të indikatorëve, çdo njëri prej të cilëve pasqyron faza dhe aspekte të ndryshme të procesit zgjedhor. Si është treguar më sipër, vlera e secilit indikatorë llogaritet si mesatare e vlerësimeve që pasqyrojnë perceptimin për tregues të ndryshme përbërës të tij, të cilët pasqyrojnë faktorët që veprojnë ose që bashkeveprojnë në fazën ose për zhvillimin e aspektit përkatës të procesit zgjedhor. Duke ju referuar vlerave mesatare të këtyre indikatorëve, të dhëna në tabelat përkatëse më sipër, Indeksi i Integritetit të zgjedhjeve, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, që u zhvilluan në 25 prill 2021, grafikisht është paraqitur në Fig. no. 2. Vlera e Indeksit të integritetit të zgjedhjeve (PEI) për këto zgjedhje rezultoi 57.65 pikë. Mbështetur në këtë vlerë të indeksit, këto zgjedhje vlerësohen në nivelin “Të moderuara”. Kontribut të ndjeshme pozitiv në vlerat e këtij indeksi kanë indikatorët që pasqyrojnë procesin e votimit ditën e zgjedhjeve dhe procesin e numërimit të votave. Të dy këto faza të procesit zgjedhor, perceptohet se janë zhvilluar në përputhje me kërkesat ligjit dhe, në përgjithësi ato i kanë plotësuar edhe kërkesat që rrjedhin nga standardet që duhet të plotësojnë zgjedhjet demokratike për procesin e votimit dhe numërimit të votave



Figurë no. 2 Indeksi i integritetit të zgjedhjeve PEI₂₀₂₁

Ndër indikatorët me efekt negativ më të madh në integritetin e zgjedhjeve vlerësohen “Ndarja e zonave zgjedhore”, “Financimi i fushatës zgjedhore”, “Ankimimet”.

- Perceptimet për efektin negativ që gjeneroi në integritetin e zgjedhjeve ndarja në zona zgjedhore të vendit, është pasojë e faktit se kjo ndarje i diskriminoi partitë e vogla dhe partitë e reja politike. Kjo ndarje perceptohet si faktor me efekt negativ në fuqinë e votës. Pragu kombëtar konsiderohet si një kushtëzim ligjor që, në mënyrë të veçantë i vendosi në pozita plotësisht të pabarabartë gare, partitë e vogla dhe kandidatët e pavarur, në krahasim me partitë e mëdha, PS e PD.

- Vlera mesatare e treguesve përbërës të financimit të fushatës zgjedhore rezultoi 2.49 (37.25 pikë), duke e klasifikuar atë në nivelin “shumë i ulët”. Ndërkohë, vlera mesatare e treguesve që pasqyrojnë fushatën zgjedhore rezultoi 2.88 (47.00 pikë) duke e klasifikuar fushatën zgjedhore në nivelin “i ulët”.

Ndër treguesit me efekte më të mëdha negative në fushatën zgjedhore, perceptohen se ishin:

(i) Vullneti i munguar i partive politike për të zbatuar kërkesat e Kodit zgjedhor në lidhje me financimin e fushatës. Shpeshësia e fenomenit të shitblerjes së votës.

(ii) Përdorimi i të dhënave personale për qëllim të garës zgjedhore.

(iii) Përdorimi për qëllime të fushatës zgjedhore të aseteve publike, fondeve financiare publike dhe aktiviteteve publike. Në veçanti përdorimi nga PS, në kundërshtim me kërkesat e ligjit, gërmën ose frymën e tyre, të të gjitha mundësive që i jepte të qenit parti qeverisëse, në nivel qëndror dhe lokal.

(iv) Niveli i pamjaftueshëm i realizimit të pritshmërive nga monitorimin, në kohë reale, i shpenzimeve të partive politike gjatë dhe për fushatën zgjedhore.

- Reagimi i institucioneve ligjzbatuese, policia e shtetit, prokuroria dhe SPAK në parandalimin e shkeljeve të ligjit zgjedhor.

- Administrimi i ankimeve dhe gjykimi i padive, perceptohet si një ndër treguesit me efekt negativ në integritetin e zgjedhjeve, si pasojë e faktit se ankimesit e konsideruan vendmimirjen e këtyre institucioneve të ndikuar nga interesi politik i partisë socialiste. Ky indikator perceptohet me një vlerë të ulët edhe sepse partitë politike humbese, PD e LSI, u deklaruan kundër rezultatit, duke e argumentuar qëndrimin e tyre me nivelin e lartë të përdorimit prej PS të aseteve publike dhe mundësive që i jepte qenia si parti qeverisëse, shitblerjen e votës dhe intimidimin e madh të zgjedhësve.

- Legjislacioni zgjedhor vlerësohet si një indikator që, në krahasim me zgjedhjet e viti 2013 dhe 2017, nuk ka bërë progres. Ai vazhdon të klasifikohet në nivelin “I moderuar”. Megjithatë në Kodin zgjedhor, të miratuar në bazë të Marreveshjes së 5 qershorit u bënë ndryshime dhe përmirësime të rëndësishme, ky indikator vlerësohet në këtë nivel të ulët, si pasojë e faktit se, ndryshimet në Kushtetutë dhe ndryshimet që pasuan në Kodin zgjedhor, u bënë pa konsensusin e paleve.

- Administrata zgjedhore vlerësohet si një indikator me efekt pozitiv në Integritetin e zgjedhjeve. Ky indikator klasifikohet në nivelin “I lartë”. Perceptim pozitiv për këtë indikator është pasojë e perceptimit për punën e Komisionerit shtetror dhe i nivelit të lartë të transparencës në punën e KQZ-së.

- Lista e zgjedhësve dhe regjistrimi i subjekteve zgjedhor janë dy indikator për të cilët vlerat mesatare të perceptimeve i klasifikojnë në nivelin “I lartë”.

- Perceptimi për rolin e medias dhe për nivelin e zbatimit prej saj të kërkesave të Kodit zgjedhor, e klasifikoi këtë indikator në nivelin “I moderuar”.

VI. Vështrim krahasues -Indeksi i integritetit të zgjedhjeve - PEI₂₀₁₇ vs PEI₂₀₂₁

Në Fig. no. 3 jepet informacioni që bënë të mundur krahasimin e perceptimeve për integritetin e zgjedhjeve dhe indikatorëve që përdoren për vlerësimin e tij, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë që janë zhvilluar në qershor, 2017 dhe prill, 2021. Të dhënat për zgjedhjet e zhvilluara në qershor 2017 janë marr nga Norris, P. and Max Grömping, M. (2019)¹

Si shihet, në krahasim me zgjedhjet për Kuvendin të zhvilluar në qershor, 2017, perceptimi për Integritetin e zgjedhjeve që u zhvilluan në prill, 2021 është rritur në vlerë me rreth 8.3 pikë përqindje. Në këtë rritje kontribut të dukshëm ka sjell rritja positive e vlerës së perceptimeve për procesin e votimit dhe numrimin të votave. Në krahasim me zgjedhjet parlamentare, 2017, për këto dy indikatorë vlera e perceptimeve për zgjedhjet, 2021, rritet respektivisht me rreth 70.5 pikë përqindje dhe 14.9 pikë përqindje.

Vlera mesatare e perceptimeve për indikatorit "Legjislacioni zgjedhor" në krahasim me zgjedhjet, 2017 ka pësuar një rritje me rreth 42.6 pikë përqindje. Kjo është pasojë e punës së bërë në kuadër të reformës zgjedhore, e cila mundësoi që, në legjislacionin zgjedhor dhe në ligjet të tjera që ndikojnë në procesin zgjedhor, të bëhen ndryshime që përmirësuan ndjeshëm këtë legjislacion. Megjithë këtë, indikatorin nuk arrin të kalojë nivelin "I moderuar", pasojë kjo e ndryshimeve që u bënë në të, pa dakortësinë e opozitës së bashkuar jashtë parlamentit.




Figure no. 2 Vlerësim i perceptimeve për indikatorët përbërës të Indeksit të integritetit të zgjedhjeve-Zgjedhje parlamentare 2017, 2021

Krahasimi i vlerave mesatare të indikatorëve që lidhen me fazën e ankimeve dhe ndarjen e zonave

¹ Electoral Integrity Worldwide, PEI 7.0, May, 2019. <http://www.electoralintegrityproject.com/>

zgjedhore, të vlerësuar për zgjedhjet, 2017 dhe 2021, tregon se për të dy këto indikatorë vlerat e perceptimeve kanë pësuar rënie të ndjeshme, respektivisht me rreth 23.5 pikë përqindje dhe 42.4 pikë përqindje. Një fakt i tillë do të thotë se:

Reformimi dhe ristrukturimi i KQZ, nga një institucion kolegjal, në një institucion me një komponente autokratike dhe dy trupa kolegjiale, nuk solli asnjë efekt pozitiv në administrimin e ankimeve. Përkundrazi, perceptimet për mënyrën se si KAS i administroi ankimet e bëra nga subjektet zgjedhore, e vlerësojnë si me pak efektive, në kuptim të zbatimit të ligjit, punën e këtij komisioni, në krahasim me mënyrën se i trajtoi ankimet KQZ gjatë zgjedhjeve parlamentare, 2017.

Duke qënë se në të dy zgjedhjet parlamentare, 2017 dhe 2021, ndarje e vendit në njësi zgjedhore ishte e njëjtë, perceptimi për efektin negativ të këtij indikator në integritetin e zgjedhjeve, shpjegohet me perceptimet për sinergjinë negative që gjeneroi kjo ndarje e pandryshuar, në bashkeveprim e saj me ndryshimet që u bënë në Kushtetutë dhe në Kodin zgjedhor, të cilat ndryshuan rregullin për koalicionet parazgjedhore dhe vendosjen e pragut kombëtar.

Megjithëse në reformën zgjedhore ju kushtua vëmëndje e veçantë problemeve të financimit të fushatës zgjedhore, vlera e perceptimeve për këtë indikator për zgjedhjet, 2021, të krahasuara me vlerat koresponduese për zgjedhjet, 2017 nuk kanë ndryshim. Ky fakt tregon se ndryshimet dhe përmirësimet që u bënë në kuadrin ligjor për financimin e fushatave zgjedhore, nuk mjaftojnë. Është akoma e nevojshme që të rikonsiderohet kjo çështje në ndryshimet e ardhshme që mund të bëhen në Kodin zgjedhor, duke ju shtuar atyre edhe ndryshimet që duhet të bëhen në ligjin për financimin e partive politike.